



**SUPPORT TO  
ELECTORAL REFORMS**

ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ  
МВЭСНТЕТЈЕ Е РЕФОРМАВЕ ЗГЈЕДНОРЕ

# **PJESËMARRJA E GRAVE NË PROCESET POLITIKE NË MAQEDONINË E VERIUT**

**NJË PASQYRË E SHUMËLLOJSHME**

**PËR BARAZINË GJINORE NË KONTEKST**

**TË ZGJEDHJEVE LOKALE 2021**



# Përmbajtja

Përmbledhje	4
Akronimet dhe shkurtesat	6
Hyrje	7
Metodologjia	9
<b>1. Konteksti</b>	<b>11</b>
1.1. Korniza e përgjithshme normative dhe institucionale	11
1.2. Angazhimet politike	12
1.3. Sistemi zgjedhor dhe kërkesat ligjore	13
<b>2. Partitë politike parandalojnë përfaqësimin e grave</b>	<b>15</b>
2.1. Politika mbetet një arenë e dominuar nga meshkujt	15
2.2. Përzgjedhja dhe përcaktimi i kandidatëve për zgjedhjet lokale	15
2.3. Tavani i qelqit i lidërsipit	18
<b>3. Barazia gjinore dhe realizimi i zgjedhjeve lokale të v. 2021</b>	<b>20</b>
3.1. Përbërja e administratës zgjedhore	20
3.2. KSHZ-ja dhe kyçja e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore	21
3.3. Vlerësimi i zbatimit të kuotës së përcaktuar gjinore zgjedhore	22
<b>4. Ndërgjegjësimi publik dhe mbështetja e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore e politike</b>	<b>23</b>
4.1. Interesi dhe perceptimi i qytetarëve për praninë e grave në proceset politike dhe zgjedhore	23

4.2. Vlerësimi i perceptimit publik të kuotës gjinore ekzistuese	25
4.3. A ka tregues të votës parapëlqyese për gratë?	27
<b>5. Barrierat dhe pengesat kryesore për pjesëmarrjen e grave</b>	<b>28</b>
5.1. Niveli i këmbënguljes, mbizotërimi dhe ndikimi i stereotipeve gjinore	28
5.2. Dominimi i politikës nga burrat	31
5.3. Dekonstruksioni i ndjeshmërisë së veçantë gjinore ndaj ekspozimit publik	31
<b>6. Ngritja e pjesëmarrjes përmes qasjes së baraspeshuar dhe portretizimit të ndershëm të kandidatëve: Roli i medias në kundërvënien e stereotipeve gjinore</b>	<b>34</b>
6.1. Shtrirja e fushatës zgjedhore 2021 në media përmes thjerrëzave gjinore	34
6.2. Qasje e padrejtë dhe portretizime të pabarabarta në media të grave kandidate gjatë zgjedhjeve lokale 2021	35
6.3. Mbështetja e pjesëmarrjes së grave: zhvendosja nga përjetësimi i stereotipeve gjinore në promovimin aktiv të barazisë gjinore	36
<b>7. Konstatimet kryesore, përfundime dhe rekomandime</b>	<b>38</b>
7.1. Reformat zgjedhore dhe korniza ligjore	38
7.2. Partitë politike	40
7.3. Administrata zgjedhore	42
7.4. Mediat	42

# Përmbledhje

Kanë kaluar njëzet vjet që kur u fut kuota gjinore në kornizën ligjore të Maqedonisë së Veriut për zgjedhjet. Kjo kuota kishte për qëllim që të rritë pjesëmarrjen e gruas në proceset zgjedhore të vendit dhe të mbështesë përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore në mbarë shoqërinë. Ky studim vlerëson progresin e arritur në këto synime të ndërmarra gjatë dy dekadave të kaluara, duke u mbështetur në hulumtimet sasimore dhe cilësore të pjesëmarrjes së grave në zgjedhjet e fundit lokale të vendit të mbajtura në tetor të vitit 2021.

Edhe përkundër zbatimit të kuotës gjinore në mbi njëzet zgjedhje kombëtare dhe lokale që kur u fut në vitin 2002, marrë në përgjithësi, hulumtimi i mëparshëm e ka vlerësuar nivelin e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike në Maqedoninë e Veriut si të ulët. Ky studim aktual i vërteton këto konstatime, i identifikon pengesat kyçe si dhe ofron rekomandime për tejkalimin e këtyre pengesave.

I ndërmarrë në kuadër të projektit *Mbështetja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut*,<sup>1</sup> ky studim u hartua me qëllim që të kuptohen më mirë shkaqet thelbësore të pengesave të vazhdueshme për pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore dhe politike. Për këtë qëllim, studimi zbatoi një anketë publike, duke kapur qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve për rolin e grave në politikë, gjithashtu organizoi edhe diskutime me fokus grupet për të vlerësuar perceptimet dhe

1 *Mbështetja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut* është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim AGJZZHB (SDC) i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore FNSGJ (IFES).

përvojat e grave kandidate aspirante, të grave anëtare të partive politike si dhe të grave këshilltare komunale të zgjedhura. Krahas shqyrtimit të praktikave të medias së vendit në raport me zgjedhjet lokale të vitit 2021, diskutimet e fokus grupeve u mbajtën edhe me gazetarët si dhe praktikuesit e medias.

Studimi dëshmon se gratë mbeten jo aq të përfaqësuara në politikën e Maqedonisë së Veriut dhe i identifikon faktorët kyçë të cilët vazhdojnë të kufizojnë më tej kapacitetet e grave për të realizuar ndikim thelbësor politik. Rezultatet e anketës së studimit të perceptimeve publike mëtej tregojnë se niveli i mbështetjes politike i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në politikë tejkalon nivelin aktual të pjesëmarrjes së grave, përfshirë brenda partive politike të vendit. Megjithatë, studimi vërteton po ashtu vazhdimësinë e stereotipeve gjinore ndërmjet qytetarëve meshkuj dhe rezistencës përkatëse ndaj vendosjes së kuotës gjinore.

Në përgjithësi, studimi arrin në përfundim se gratë vazhdojnë të luftojnë për të drejta të barabarta dhe pjesëmarrje në proceset politike e zgjedhore të cilat ende dominohen nga burrat. Si për shembull, gratë ende luftojnë për të fituar nominime në listat e kandidatëve, nga partitë e tyre politike, për mandate fituese dhe për mbështetje të mjaftueshme gjatë fushatave zgjedhore. Ato gjithashtu duhet të marrin mbështetjen e votuesve në një ambient social në të cilin qëndrimet patriarkale vazhdojnë të rrojnë në mesin e trupit votues dhe të mbeten përjetësisht në media. Gratë e përfshira në politikë ballafaqohen me



sfida të veçanta që dalin nga ekspozimi publik, mbi të gjitha, nga portretizimi fytes i tyre në mediat tradicionale e onlajn dhe përdorimi i gjuhës ofenduese si dhe gjuhës tjetër diskriminuese në rrjetet sociale.

Studimi ofron një numër të konsiderueshëm rekomandimesh dhe propozimesh praktike për aktivitetet e pikësnyuara në vijim e sipër, me qëllim që të luftohen pengesat kryesore të identifikuara për një pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë dhe në proceset zgjedhore. Këto masa dhe strategji të rekomanduara janë zhvilluar në pajtim me konstatimet e studimit dhe përfshijnë propozime për ndryshime në kornizën legjislative dhe rregullatore. Në lidhje me përdorimin e kuotave gjinore, veçanërisht si mjete konsolidimi dhe rritjeje të numrit të grave në postet e zgjedhura, studimi propozon futjen e qasjes së “sistemit zinxhir (këmbyes)” ose “barazisë vertikale” në listat e tyre të kandidatëve. Ky sistem kërkon që partitë të alternojnë meshkujt dhe femrat në listat e tyre të kandidatëve, duke arritur kështu një përfaqësim sa më të drejtë dhe më proporcional<sup>2</sup>. Më tej, për të ndihmuar në mbrojtjen e grave nga abuzimi onlajn në bazë gjinore, studimi propozon përmirësime në rregullimin e përmbajtjeve onlajn gjatë zgjedhjeve. Studimi po ashtu rekomandon të ndërmerren përpjekje të përbashkëta për të

përmirësuar kapacitetet e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve që të prodhojë dhe përhapë të dhëna dhe propozime zgjedhore gjithëpërfshirëse të zbërthyer sipas seksit biologjik dhe zbatimin e një programi edukativ që pikësynon barazinë gjinore dhe aktivitetet e veçanta të ndërtimit të kapaciteteve për gratë candidate.

2 Një “sistem alternimi gjinor i kandidatëve në listen partiake”, në fjalorthin e termave të Komisionit të Venecias, në [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-EL\(2020\)006-bil](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-EL(2020)006-bil)

# Akronimet dhe shkurtesat

**ASHMAA** Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

**BDI** Bashkimi demokratik për integrim

**DK** Deputet në kuvend

**DOM** Ripërtëritja demokratike e Maqedonisë

**IEBGJ** Instituti evropian i barazisë gjinore

**IFES** Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore

**KD** Klubi i deputeteve

**KE** Këshilli i Evropës

**KE** Komisioni Evropian

**KEFDG** Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

**KKZ** Komisionet komunale të zgjedhjeve

**KSHZ** Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

**KZ** Këshillat zgjedhorë

**LDP** Partia demokratike liberale

**MVZ** Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve

**NSDP** Partia e re socialdemokrate

**ODHIR** Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat njeriut

**OKB** Organizata e kombeve të bashkuara

**OSBE** Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

**OZ** Organet zgjedhore

**PDSH** Partia demokratike Shqiptare

**SDC** Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim

**TMORO** Organizata atdhetare maqedonase për përtëritjen radikale

**UE** Unioni Evropian

**USAID** Agjencia e shteteve të bashkuara për zhvillim ndërkombëtar

# Hyrje

**K**uota gjinore u fut në kornizën ligjore zgjedhore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2002 për të rritur pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe zgjedhore dhe të mbështesë arritjen për një barazi më të madhe gjinore, jo vetëm brenda kuvendeve të zgjedhura të vendit, por në mbarë shoqërinë në tërësi. Formula e kuotës gjinore është përmirësuar që nga inkorporimi i saj, me një rritje të pragut të përfaqësimit nga 30 në 40 përqind dhe me shtimin e dy mandateve të vendosura.<sup>3</sup> Disa nisma të tjera për promovimin dhe mbështetjen e barazisë gjinore janë zbatuar gjithashtu që nga viti 2002 dhe janë kryer disa studime mbi parametrat kryesorë të pjesëmarrjes së grave.

Megjithatë, njëzet vjet pas futjes të kuotës gjinore rritja e numrit të grave në kuvendet e zgjedhura ende nuk duket të ketë tërhequr ndryshime adekuate në mos baraspeshën e fuqisë ndërmjet burrave dhe grave në fushën politike dhe zgjedhore. Përkundër kësaj mungese të progresit, rezultatet për kryetarin e komunës në zgjedhjet lokale të vitit 2021 vërtetojnë se numri i grave të zgjedhura është dukshëm më i ulët ku nuk është vendosur pragu i kuotave.

Ky studim është ndërmarrë në kuadër të projektit *Mbështetje e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut*, i Agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES). Projekti

3 Rregulloret për renditjen gjinore në listat partiake. Shih nenin 64.5 të Kodit zgjedhor të Maqedonisë së Veriut: "Të paktën një nga tre vendet duhet të rezervohet për gjininë jo aq të përfaqësuar, me të paktën një vend plotësues nga çdo dhjetë vende."


ka për synim që të mbështesë proceset zgjedhore të besueshme dhe demokratike të cilat lehtësojnë një pjesëmarrje më të madhe politike si dhe integrim social, duke u mundësuar zgjedhësve të zgjedhin lirshëm përfaqësuesit e tyre dhe këta të fundit të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Ky studim përfshin një anketë dhe analizë të perceptimit publik të përfaqësimit të grave në politikë dhe të qasjes së grave në leadership dhe në postet vendimmarrëse në Maqedoninë e Veriut. Arsyeja e këtij përqendrimi bazohet në premisën se perceptimet publike pozitive të përfaqësimit të grave në politikë kanë një rol vendimtar në lehtësimin e përfaqësimit thelbësor të barabartë gjinor përtej arritjes së çfarëdo "mase kritike"<sup>4</sup>. Nga ky këndvështrim, studimi përfshin analizën e të dhënave veçanërisht në lidhje me zgjedhjet lokale të tetorit 2021 që të nxjerrë mësimet dhe të zhvillojë rekomandime për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në proceset politike dhe zgjedhore në vend.

Më konkretisht, studimi ka këto synime dhe objektiva:

- të analizojë të dhënat zgjedhore ;
- t'i identifikojë çështjet dhe të propozojë përmirësime për organet zgjedhore si dhe proceset zgjedhore;

4 Në studimet e sjelljes legjislative të grave, koncepti i masës kritike është përdorur si mjet për kuptimin e marrëdhënies ndërmjet përqindjes së ligjëvënësve femra dhe miratimit të legjislacionit të dobishëm për gratë si grup.



- t'i identifikojë barrierat kryesore për një perceptim më pozitiv të kandidateve gra ndërmjet zgjedhësve dhe të propozojë masa dhe strategji që të tejkalohen stereotipet e identifikuara gjinore;
- të kuptohen më mirë çështjet kryesore lidhur me paraqitjen e grave në skenën politike, veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore dhe në media;
- të propozojë strategji praktike për të zmadhuar pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore dhe në jetën publike;
- të japë një kontribut pozitiv dhe informativ në diskutimet se si të përmirësohet pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe përfaqësimin politik përmes përhapjes së konstatimeve kyçe të studimit të palët e prekura zgjedhore.

Studimi është strukturuar si vijon: kapitulli i parë ofron një përmbledhje të kontekstit normativ dhe institucional të pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike në Maqedoninë e Veriut. Kapitulli i dytë i identifikon çështjet kryesore lidhur me barazinë gjinore dhe realizimin e zgjedhjeve. Kapitujt pasues paraqesin një analizë të rezultateve të anketës së qytetarëve dhe vlerësimin e pengesave aktuale të pjesëmarrjes së grave, duke përfshirë rolin e medias në përjetësimin e stereotipave gjinorë. Kapitulli i fundit përmbledh konstatimet kryesore dhe ofron rekomandime për arritjen e barazisë më të madhe gjinore në politikë, duke përfshirë veprimet e veçanta për të tejkaluar pengesat të identifikuara në studim.



# Metodologjia

Qasja metodologjike e aplikuar në këtë studim u disenjua me qëllim që t'i kapë perceptimet e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike të një numri aktorësh. Këtu u përfshinë perceptimet dhe përvojat e grave politikane në pozitë publike (funkcion) dhe të kandidateve gra që kandiduan në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021, si dhe perceptimet mbizotëruese për gratë në politikë në nga publiku, gazetarët dhe përfaqësuesit e tjerë të medias.

Për të matur dhe dokumentuar nivelet aktuale të ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjes së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në politikë, studimi përfshiu pyetësorë të strukturuar për të shpalosur opinionet e qytetarëve në 27 çështjet kyçe. Këto përfshinin pyetje mbi perceptimet publike të grave kandidate, nivelet e respektimit të dispozitave të kuotës gjinore dhe pyetjeve që kanë për synim të identifikojnë stereotipat kryesorë gjinorë dhe format të tjera të vazhdueshme të barrierave dhe pengesave për pjesëmarrjen e grave në politikë.

Pyetësori u zbatua duke përdorur metodologjinë e intervistimit personal i ndihmuar nga kompjuteri IPNK (CAPI) që të anketojë një grup të anketuarish të përzgjedhur, me qëllim që të pasqyrohet struktura e popullsisë së vendit. Kampioni përfaqësues i shtresuar në më tepër faza u përdor për të përzgjedhur 1,085 të anketuar që reflekton shpërndarjen e popullatës së përgjithshme në raport me etninë, moshën, seksin biologjik dhe vendbanimin në tetë rajone të vendit. Marzha e

vlerësuar e gabimit ishte 2.97 pikë përqindjeje, me 95 përqind të nivelit të besueshmërisë.


Si plotësim, janë mbajtur katër fokus grupe me (i) gratë anëtare të partive politike; (ii) kandidatet gra aspirante në zgjedhjet lokale të v. 2021; (iii) gratë këshilltare të përzgjedhura; dhe (iv) gazetarët dhe përfaqësuesit e tjerë të medias, me qëllim që të shpalosen dhe dokumentohen përvojat, perceptimet, opinionet dhe rekomandimet e këtyre aktorëve në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe përfaqësimin në politikë.

Fokus grupet përfshinin gjithsej 32 pjesëmarrës dhe janë mbajtur ndërmjet 17 dhjetorit të vitit 2021 dhe 10 shkurtit të vitit 2022, me anë të diskutimeve të strukturuar rreth pyetësorëve të synuar. Temat specifike përfshinin pyetje në lidhje me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve partiakë për zgjedhjet dhe pjesëmarrja e grave në fushatën e zgjedhjeve lokale 2021, perceptimet e pjesëmarrësve të pranisë së grave në politikë dhe në media, mbizotërimi i njëanësisë gjinore në shtrirjen mediatike të grave në politikë si dhe sfidave kryesore për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

Për të plotësuar të dhënat cilësore dhe sasore të anketës dhe fokus grupit u rishikuan nga zyra studimet e mëparshme dhe legjislacioni përkatës zgjedhor së bashku me të dhënat e aplikacionit onlajn të kandidatëve të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (KSHZ) si dhe nga intervistat e drejtpërdrejta me aktorët kryesorë.

**Figura 1**

Struktura demografike e të anketuarve në anketë




**Figura 2**

Të anketuarit” e anketës të zbërthyer sipas seksit biologjik, grup moshave dhe arsimit


Shpërndarja sipas seksit biologjik




Shpërndarja sipas grup moshave



Shpërndarja sipas stasusit të punës



Shpërndarja sipas arsimit



# 1. Konteksti

Sipas Regjistrimit të popullsisë, amvisërisë dhe banesave të vitit 2021, ekziston një përqindje pothuajse e barabartë e meshkujve dhe e femrave në popullatën e Maqedonisë së Veriut prej 1,836,713, gratë që përbëjnë 50.4 përqind dhe burrat që përbëjnë 49.6 përqind të këtij totali.<sup>5</sup> Megjithëse hulumtimi krahasues i grave në politikë e ka renditur Maqedoninë e Veriut në vendin e 29-të nga 188 vende sa i përket përqindjes së grave të zgjedhura në kuvend, i njëjti hulumtim e rendit vendin shumë më poshtë sa i përket numrit të grave të emëruara në postet ministrore, në vendin e 93-të prej 182 vendeve.<sup>6</sup> Kjo pabarazi e dukshme ndërmjet renditjes së vendit për përfaqësimin e grave të zgjedhura përkundrejt posteve përcaktuese mund t'i atribuohet mungesës së formulës së kuotës gjinore ose mungesës së pajtueshmërisë me dispozitat e barazinë gjinore në postet e përcaktuara dhe të zgjedhura.

Raporti përfundimtar i Misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve zbatuar nga zyra e OSBE-së për Institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODHIR) në Maqedoninë e Veriut për zgjedhjet lokale të tetorit 2021, theksoi se gratë qëndrojnë “jo aq të përfaqësuara në zyrat publike, duke mbajtur 45 nga 120 vende (37.5 përqind) në kuvendin aktual dhe 4 nga 15 poste ministrore në qeveri”.<sup>7</sup>

5 Ky regjistrim mund të gjendet në: [https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie\\_en.aspx?rbtxt=146](https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_en.aspx?rbtxt=146)

6 Shih *Gratë në politikë 2021* (Bashkimi ndërparlamentar dhe UN Women), duke pasyruar përcaktimet/emërimet që nga 1 janari i v. 2021 në: <https://www.ipu.org/news/women-in-politics-2021>

7 Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/514666>

## 1.1. Korniza e përgjithshme normative dhe institucionale

Në tre dekadat që kur vendi u bë republikë parlamentare e pavarur në vitin 1991, është angazhuar mjaft në përparimin e barazisë gjinore, përfshirë ratifikimet e tij të kornizave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të politikave lidhur me barazinë gjinore:

- 1994: ratifikimi i Konventës së OKB-së në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), përfshirë Protokollin e saj opsional
- 1995: ratifikimi i Platformës së Pekinit për veprim e OKB-së
- 1997: ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore
- 2018: ratifikimi i “Konventës së Stambollit” në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Vendi i është përkushtuar edhe Agjendës së OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë.<sup>8</sup>

Neni 9 i Kushtetutës së vitit 1991 të vendit parasheh barazinë e të gjithë qytetarëve pavarësisht seksit biologjik, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare dhe sociale, bindjeve fetare dhe politike, pasurisë dhe statusit social. Megjithëse nuk ekziston një dispozitë e veçantë e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në kushtetutë, dispozitat e veçanta që mbrojnë të

8 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurisë së OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, si dhe rezolutat pasuese. Në v. 2021, Ministria e mbrojtjes dhe armata miratuan planin operacional për zbatimin e rezolutës 1325 të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe për koordinimin institucional në partneritet me shoqërinë qytetare.



drejtat e grave u futën në Ligjin për marrëdhëniet e punës në v. 1993. Si plotësim, në vitin 2006 u miratua Ligji për mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat dhe Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili kaloi në vitin 2010 si pjesë e Planit kombëtar të veprimit të vendit për zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2015–2020) Strategjisë kombëtare të barazisë dhe mos diskriminimit për 2016–2020.

Në kuvendin e Maqedonisë së Veriut, Klubi i deputeteve (KD) i përbërë nga deputetet e kuvendit (DK) me mandat aktual u formua në v. 2003 dhe qysh atëherë ka shërbyer si një organ efektiv këshillëdhënës joformal për të drejtat dhe përfaqësimin e grave në politikë. Si për shembull, KD-ja ka një rol domethënës në bashkimin e grave nga partitë e ndryshme politike për të gjetur zgjidhje të përbashkëta në trajtimin e barazisë gjinore. KD-ja miratoi Planin strategjik të miratuar për v. 2018–2020 me çka ripërtërin fokusin e saj duke i dalë në mbrojtje përfaqësimit sa më të mirë të grave si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Në pajtim me këtë plan, KD-ja nisi një diskutim për ndryshimet në Kodin zgjedhor, duke përfshirë një propozim për futjen e kuotës gjinore prej 50 përqind. Megjithatë, ky propozim nuk bënte pjesë në ndryshimet e parapara të kodit zgjedhor të miratuar në shtator të vitit 2021.

Komisioni parlamentar i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat gjithashtu ka luajtur një rol

qendror në ligjbërjen e ndjeshmërisë gjinore dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare të vendit për barazinë gjinore në legjislacionin ndërkombëtar. Komisioni përbëhet nga 11 përfaqësues të të gjitha partive politike, duke përfshirë edhe kryesuesin. Pjesëmarrja e meshkujve në këtë komision ka qenë shumë e ulët vitet e fundit, ku vetëm një përfaqësues ka marrë pjesë nga viti 2016 deri në vitin 2020. Përbërja e tanishme e komisionit përfshin dy zëvendës anëtarë meshkuj, mirëpo asnjë anëtar përfaqësues.

Në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta,<sup>9</sup> në vitin 2020 u krijua grupi ndërministror këshillëdhënës me “koordinuesit gjinorë” të vendosur si në ministritë, ashtu edhe në nivelin e qeverisjes lokale. Ministria e punës dhe politikës sociale ka për detyrë të koordinojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji në të gjitha organet e administratës publike si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

## 1.2. Angazhimet politike

Në mars të v. 2021, u hartua një Ligj i ri për barazinë gjinore për të zëvendësuar ligjin ekzistues për mundësitë e barabarta. Është me rëndësi, se ky projekt ligjor propozonte futjen e kuotës ligjore në organet udhëheqëse dhe ekzekutive të partive politike.

<sup>9</sup> Nenet 10, 11, 12 dhe 14 të Ligjit mbi mundësitë e barabarta.

Kriteret e konvergencës për anëtarësimin në UE kërkojnë që vendi të bëjë legjislacionin e tij në pajtim me Direktivat gjinore të UE-së që pasqyrojnë angazhimet e shteteve anëtare të UE-së për mbrojtjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave.<sup>10</sup> Në *Udhërrëfyesin e tij për barazinë midis grave dhe burrave (2006–2012)*, Komisioni Evropian u shtoi këtyre kriterëve nevojën që anëtarët të zhvillojnë dhe të ruajnë Indeksin e barazisë gjinore kombëtare, duke përfshirë më vonë këtë kërkesë në Planin e veprimit të strategjisë për barazi ndërmjet grave dhe burrave në vitet 2010–2015. Në pajtim me këtë kriter, Indeksi kombëtar i barazisë gjinore për Maqedoninë e Veriut u zhvillua nga Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Entit shtetëror të statistikave në bashkëpunim me Institutin Evropian të barazisë gjinore (EIGE) dhe i publikuar në v. 2019. Sa i përket temës së gjinisë dhe pushtetit politik, indeksi arriti në përfundimet e mëposhtme:

Dallimi më i ulët gjinor është në treguesin për pjesëmarrjen e grave në kuvend, i cili është kryesisht për shkak të kuotave të përcaktuara me ligj për zgjedhjen e deputetëve nga gjinia më pak e përfaqësuar në parlament. Në anën tjetër, dallimi më i madh gjinor në nën sferën e pushtetit politik është në pjesëmarrjen [e grave] si ministra në qeveri, ku gratë përfaqësohen në përqindje shumë më të vogël krahasuar me burrat ... Treguesit tregojnë se nëse nuk do të kishte fare kuota për pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në sferat e ndryshme të pushtetit politik (për shembull: Qeveria, Kuvendi, qeverisja lokale), pjesëmarrja e grave do të kishte qenë dukshëm më e vogël krahasuar me burrat, p.sh. shpërndarja e pushtetit politik është disproporcionalisht më e lartë në të mirë të burrave.<sup>11</sup>

Edhe pse doli sheshit se përdorimi i kuotës gjinore ndihmoi në përmirësimin e barazisë gjinore në kuvend dhe në këshillat komunalë, indeksi vërejtë se përfaqësimi i grave në institucionet e tjera publike

10 Këto direktiva janë direktivat e Këshillit Evropian 2004/113/EC mbi parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin me mallëra dhe shërbime dhe direktiva 2006/54/EC mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në raport me punësimin dhe veprimtarinë.

11 Raporti kombëtar i indeksit të barazisë gjinore bazohet në metodologjinë dhe kornizën e v. 2017 Indeksi i barazisë gjinore i zhvilluar nga Instituti Evropian për barazi gjinore (EIGE, <http://eige.europa.eu/>). Të dhënat e përdorura për llogaritjen e indeksit të barazisë gjinore për Maqedoninë e Veriut i referohen vitit 2015 dhe bazohen në indeksin e EIGE-s- indeksi i metodologjisë për v. 2017.

të vendit mbeti nën objektivin prej 40 përqind të vendosur nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës, Rec (2003)3 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen publike dhe politike.

### 1.3. Sistemi zgjedhor dhe kërkesat ligjore

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut është organ njëdhomësh me numër maksimal prej 123 deputetësh. Secila nga gjashtë njësitë zgjedhore të vendit zgjedh drejtpërdrejt njëzet deputetë për një mandat katërvjeçar sipas sistemit proporcional të përfaqësimit me anë të listave të mbyllura<sup>12</sup> me vende të caktuara për listat e kandidatëve sipas metodës së *Dontit* me mesatare më të lartë<sup>13</sup>.

Këshilltarët komunalë dhe kryetarët e komunave gjithashtu zgjedhen për një mandat katër vjeçar në zgjedhjet e drejtpërdrejta të mbajtura në 80 komunat e vendit dhe në qytetin e Shkupit me anë të modelit të përfaqësimit proporcional me listë të mbyllur. Numri i këshilltarëve lëviz prej 9 në 33 sipas popullatës së komunës, gjersa 45 përfaqësues janë zgjedhur në këshillin e qytetit të Shkupit. Për ndarjen e mandateve përdoret e njëjta formulë “mesatarja e lartë” ashtu si për rindarjen e mandateve në këshillat e sapo zgjedhura.

Zgjedhjet presidenciale dhe të kryetarëve të komunave zhvillohen sipas sistemit të shumicës me dy raunde, me çka nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave të hedhura në raundin e parë, atëherë dy javë më vonë zhvillohet raundi i dytë ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota. Të paktën një e treta e zgjedhësve të regjistruar në komunë duhet të votojnë në raundin e parë që zgjedhjet për kryetar të komunës të jenë të vlefshme, përndryshe zgjedh-

12 Deri në tre deputetë janë zgjedhur nga një njësi e vetme zgjedhore e vendit, në pajtim me nenin 175.2 të Kodit zgjedhor.

13 Ndarja e vendeve në organet kolegjiale, siç janë kuvendet kërkon një metodë për të përkthyer votat proporcionalisht në mandate të tëra. Metoda e Dontit është formulë matematikore e përdorur gjerësisht në sistemet e përfaqësimit proporcional, megjithëse çon në rezultate më pak proporcionale sesa sistemet e tjera për ndarjen e mandateve, siç janë metodat e Hare-Niemeyer dhe Sainte-Laguë/Schepers. Respektivisht, priret të rrisë përparësinë për listat zgjedhore të cilat fitojnë më shumë vota në dem të atyre që kanë më pak vota. Megjithatë, është e fiksuar në lehtësimin e formimit të shumicës dhe, në këtë mënyrë, në sigurimin e funksionimit parlamentar. Kuptimi i metodës së Dontit, ndarja e mandateve parlamentare dhe postet e lidhshme » Parlamenti Evropian, në [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/637966/EPRS\\_BRI\(2019\)637](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/637966/EPRS_BRI(2019)637)

jet duhet të përsëriten. (Këto kërkesa për votim nuk zbatohet për raundet e dyta të mundshme dhe për zgjedhjet e këshillave.)

Futja e suksesshme e këtyre votave të përcaktuara gjinore prej 30% si masa të veçanta në legjislacionin e v. 2002 dhe 2004 ishte rezultati i bashkëpunimit jetik ndërpartiak dhe bashkëpunimit ndërmjet grave politike të përzgjedhura dhe grave në lëvizjet e shoqërisë qytetare. Ky bashkëpunim kishte një rëndësi të madhe, duke lehtësuar përmirësimet e mëvonshme gjatë hartimit të formulës së kuotës gjinore me përfshirjen e dy kritereve të vendosjes.



### Kodi Zgjedhor, Neni 64(5):

“Në listen e dorëzuar të kandidatëve për deputetë nga paragrafi 2 i këtij neni dhe për anëtarët e këshillit komunal dhe të qytetit të Shkupit të paragrafit 3 të këtij neni, së paku 40% e kandidatëve do t'i takojnë seksit më pak të përfaqësuar, përkatësisht: në çdo vend të tretë së paku një vend t'i takojë seksit më pak të përfaqësuar dhe po ashtu, të pakën një vend në çdo dhjetë vende.”

Që nga v. 2015, formula e kuotës ekzistuese është përmirësuar. Ka imponuar pragun prej 40 për qind të kandidateve femra në listat për zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Mirëpo, në praktikë, kjo kuotë jo gjithmonë përkthehet drejtpërdrejtë në atë se 40 për qind e deputetëve dhe këshilltarëve të zgjedhur të jenë gra. Për shembull, zgjedhjet lokale të mbajtura në v. 2017 rezultuan që vetëm 15 nga gjithsej 81 komunat në vend të kenë 40 ose më shumë për qind këshilltare gra, ndërsa 31 komuna kishin më pak se 30 për qind këshilltare gra. Pas zgjedhjeve më të fundit lokale të tetorit 2021 dhe bazuar në të dhënat e këshilltarëve të zgjedhur për 68 komuna nga 81 gjithsej, vetëm 21 komuna kishin më shumë se 40 për qind të këshilltareve gra dhe 18 komuna kishin më pak se 30 për qind.<sup>14</sup>

Si plotësim, duhet vënë në dukje se Kodi zgjedhor nuk i përfshin dispozitat për t'u siguruar përfaqësimi gjinor i baraspeshuar gjatë përcaktimit të bartësve të listave të kandidatëve nga ana e garuesve zgjedhorë.

14 Nuk kishte të dhëna në dispozicion për 13 nga 81 komunat, për shkak se nuk kishte qasje në uebsajtet/faqet e tyre.

Zgjedhja e kryetarëve të komunave bëhet sipas modelit të shumicës, i cili shpesh cilësohet si i pafavorshëm për përfaqësimin e grave. Dy sistemet e ndryshme zgjedhore të përdorura në nivel lokal për zgjedhjen e këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave japin rezultate të kundërta sa i përket përfaqësimit gjinor. Vetëm gjashtë kryetare gra të komunave u zgjodhën në 81 njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe në qytetin e Shkupit në v. 2017 dhe vetëm dy gra u zgjodhën për kryetare të komunave në zgjedhjet e v. 2021. Përqindja e deputeteve dhe këshilltareve lokale ka shënuar rritje të vazhdueshme që nga v. 2002. Këto prirje tregojnë qartësisht se gratë kanë arritur të përfaqësohen më mirë në ato institucione në të cilat është zbatuar kuota gjinore, duke sugjeruar më tej se “tavani i qelqit<sup>15</sup>” për postet e lidërshpit, siç janë kryetarët e komunave, është më vështirë për t'u thyer.

Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit apo të kryetarit të komunës, Kodi zgjedhor nuk parashikon organizimin e zgjedhjeve të reja, të veçanta, por bartjen e mandatit kandidatit të radhës në listë. Në këtë rrethanë, Kodi zgjedhor parashikon ruajtjen e dispozitave që i japin përparësi përfaqësimit gjinor, me çka kandidatja e radhës në listë bëhet deputete ose këshilltare komunale për periudhën e mbetur të mandatit.

15 “Tavani i qelqit” është një metaforë që përdoret për të paraqitur pengesën e padukshme e cila parandalon gratë të ngrihen përtej një niveli të caktuar. Kjo shpesh është për shkak të diskriminimit të bazuar në seksizëm.

## 2. Partitë politike parandalojnë përfaqësimin e grave

Përfaqësimi jo aq i duhur i grave në Maqedoninë e Veriut është një model i përgjithshëm, i dukshëm në postet qeveritare dhe në postet e tjera përcaktuese e zgjedhore në nivelin qendror dhe lokal, veçanërisht në lidhshmëri dhe në strukturën e partive politike. Rezultati i zgjedhjeve lokale të vitit 2021 jep sinjalin e mëtejshëm se vetëm kuotat përcaktuese ligjore nuk mjaftojnë për të siguruar ndryshimin në baraspeshën ekzistuese ndërmjet burrave dhe grave brenda partive politike. Dominimi mashkullor i politikës në përgjithësi dhe i partive politike në veçanti ka ndikim domethënës në procesin e përzgjedhjes së kandidatit dhe paraqet pengesë madhore për qasjen e politikaneve në postet udhëheqëse.

### 2.1. Politika mbetet një arenë e dominuar nga meshkujt

Vendi asnjëherë nuk ka pasur grua për kryetare shteti ose kryeministre dhe ka pasur vetëm një grua për kryetare të kuvendit, megjithëse duhet theksuar se kandidatet gra kanë kandiduar, ndonëse pa sukses, për kryetaren e shtetit. Në kuadër të qeverisë aktuale, vetëm tre poste ministrore janë udhëhequr nga gratë (nga 16 gjithsej), ndërsa vetëm një grua mban postin e zëvendëskryeministrit (nga 4 gjithsej)<sup>16</sup>. Studimi i vitit 2019 mbi pjesëmarrjen e gruas në Maqedoninë e Veriut<sup>17</sup> theksoi faktin se vetëm katër

16 Qeveria e udhëhequr nga Dimitar Kovačevski, e zgjedhur në janar 2022. <https://vlada.mk/node/18031?ln=en-gb>

17 *Pjesëmarrja politike e grave në Maqedoninë e Veriut*, koleksion studimesh dhe punimesh hulumtuese - shkencore, Fondacioni Uestminster për Demokraci, Shkup 2019.

gra (25%) mbanin postet e drejtorit të përgjithshëm ose të sekretarit shtetëror, ndërsa përfaqësimi i grave në mesin e drejtorëve, zëvendësve, zëdhënësve dhe koordinatorëve të emëruar nga qeveria ishte vetëm 8.85 përqind. Studimi i njëjtë vërejtë se emërimet në subjektet publike dhe kompanitë shtetërore nga udhëheqësit e partive politike u jepeshin kryesisht burrave me vetëm 11.18 përqind të grave janë të përcaktuara për këto poste.

Ky nivel i ulët i përfaqësimit të grave në qeveri pjesën më të madhe e pasqyron nivelin e ulët të pjesëmarrjes së grave në partitë politike, ku ato ende ballafaqohen me një rezistencë të fuqishme në pikëpamje të qasjes për mbështetje partiake, ashtu edhe në përfaqësimin në strukturat udhëheqëse partiake.


### 2.2. Përzgjedhja dhe përcaktimi i kandidatëve për zgjedhjet lokale

Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, 28 parti politike, gjashtë koalicionet dhe 58 grupe zgjedhësish paraqitën gjithsej 10,649 kandidatë në 571 lista për zgjedhjet e këshillit dhe 299 kandidatë, duke përfshirë 25 të pavarur, për zgjedhjet e kryetarëve të komunave.

Kandidatët që garuan për postet e këshilltarëve të komunave në këto zgjedhje, 56.02 përqind ishin bura dhe 43.98 përqind ishin gra. Megjithëse numri i grave që kryesojnë listat e kandidatëve të partive në zgjedhjet e vitit 2021 u rrit në 19 përqind nga 14 përqind në zgjedhjet e mëparshme lokale

**Figura 3**

Përqindja e grave në mesin e bartëseve të listave të këshilltarëve



të v. 2017, kjo shifër ende është shumë larg barazisë gjinore.

Siç shihet në grafikun e mësipërm, nga 81 kryesues të listës së kandidatëve për këshilltarë nga LSDM, 28 ishin gra (c.34%), përderisa në VMRO-DPMNE përfaqësimi i grave ishte 20 përqind, që 15 nga 74 kryesues të listave për këshilltarë ishin gra. Përqindja e grave, kryesuese të listave nga PDSH ishte shumë e ulët, 12.5 përqind, ndërsa BDI kishte përcaktuar rreth 17 përqind, ose gjashtë prej 34 kryesuesve të listave ishin gra.

Siç vërejtëm më parë, imponimi i kuotës gjinore prej 40 përqind për përzgjedhjen e kandidatëve (për listat e kandidatëve) nuk do të thotë që automatikisht 40 përqind e kandidatëve të zgjedhur të jenë gra. Kjo është domethënëse, sepse gjasat e kandidatit për t'u zgjedhur rriten më shumë në sistemin e përfaqësimit proporcional me “listë të mbyllur” nëse pozicionimi i tyre është më i lartë në listë. Duke i dhënë përparësi renditjes më të lartë në listat e kandidatëve, është e udhës të krahasohet përbërja gjinore e këshillave të zgjedhur komunalë dhe renditja e këshilltarëve aspirantë në listat e kandidatëve të partive politike. Kështu, përderisa gratë kryesonin me 19 përqind në listat partiake të kandidatëve në zgjedhjet lokale të v. 2021, 35.9 përqind e vendeve të dyta dhe 59.44 përqind e vendeve të treta u ndaheshin grave. Analiza e kryqëzuar e këtyre listave të kandidatëve sipas përkatësisë kryesore etnike të partive politike tregon se kandidatet gra të propozu-

ara nga partitë politike joshqiptare kryesonin me 21 përqind në listat e tyre të kandidatëve, ndërsa 40 përqind e vendeve të dyta dhe 55 përqind e vendeve të treta të këtyre listave u ndaheshin grave. Partitë politike shqiptare i vendosën kandidatet gra në vendin e parë me 11 përqind të listave të tyre, në vendin e dytë me 16 përqind të listave dhe në vendin e tretë me 78 përqind.

Këto shifra tregojnë për një zgjedhje të qëllimshme të partive politike që në përgjithësi t'i vendosin kandidatet gra në rangun më të ulët të mundshëm në listat e kandidatëve. Analiza e mëtejshme e ndërthurur e listave të kandidatëve që garojnë në pesë komunat e vendit<sup>18</sup> me më pak se 20 përqind të grave të zgjedhura në këshillat e tyre demonstroi modelin e njëjtë të renditjes, me gratë në pozitën e tretë me 61.8 përqind në të gjitha 34 listat garuese. Përqindja mesatare e përfaqësimit të grave në këshillat lokalë në tërë vendin është 36 përqind, duke zbritur në 29 përqind në komunat e rajoneve rurale<sup>19</sup>.

Në bazë të të dhënave të KSHZ-së në zgjedhjet e v. 2021 vetëm 25 prej 299 grave u konfirmuan si kandidatë për 80 komuna dhe qytetin e Shkupit,


18 Komuna e Novacit: 1 prej 9 (11.11%); Debarcë: 2 prej 11 (18.18%); Gradsko: 1 prej 9 (11.11%); Dolneni: 3 prej 16 (18.75%); dhe Shuto Orizarë (15%).

19 Për këtë pikë, shih N. Korunovska et al. “Gratë në politikë: Rruga drejt funksioneve politike dhe ndikimi në nivelin lokal në Maqedoni”, Reaktor – Hulimtimi në aksion, Shkup 2015.



**Figura 4**

Përqindja e grave në mesin e kandidatëve për kryetarë të komunave



p.sh. 8.72 përqind e kandidatëve për kryetarë të komunave ishin gra përderisa 91.28 përqind ishin burra.

As koalicioni i Aleancës së Shqiptarëve dhe i partisë Alternativa, as Besa nuk propozuan një grua të vetme kandidate për kryetare të komunës.

Më pak se pesë përqind e kandidatëve të VMRO-DPMNE-së për kryetarë të komunave në zgjedhjet e v. 2021 ishin gra, me tri gra nga gjithsej 63 kandidatë që garonin për postet e kryetarëve të komunave në komunat e Berovës, Krushevës dhe Qendrës.

Nga kandidatët e BDI-së për kryetar komune, vetëm 5.2 përqind ishin gra. Si BDI ashtu edhe PDSH kishin vetëm një kandidate grua.

Nga 69 kandidatët për kryetar të komunave të paraqitur nga LSDM, vetëm pesë (7.2%) ishin gra. Për më tepër, këta kandidatë u paraqitën në komunat e vogla (p.sh. Makedonska Kamenica, Haraçina, Mogila, Petroveci dhe Staro Nagoriçani). Përqindja mesatare kombëtare e grave kandidate për kryetare të komunave në zgjedhjet e v. 2021 u rrit pjesërisht nga partia Levica (‘E majta’), e cila propozoi dy gra nga gjithsej tetë kandidatë të kryetarëve të komunave dhe nga lëvizja “Të vendosur për ndryshime” e iniciuar nga LDP dhe DOM, të cilët propozuan pesë gra në mesin e 18 kandidatëve për kryetar të komunave.

Nga 27 kandidatët e pavarur që garuan për kryetarë të komunave në v. 2021, vetëm dy (7.41%)

ishin gra. Ndërkaq, në komunën e Shkupit, Kisella Vodë, partitë DOM / LDP, E majta dhe TMORO propozuan tri gra kandidate për kryetar të komunës.<sup>20</sup>

Gratë kandidate aspirante dhe këshilltare të zgjedhura të cilat morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve të mbajtura për këtë studim treguan se ato i kishin rekomanduar kryesisht këshillat lokale të partive të tyre, por ndonjëherë edhe me kërkesë të organeve të larta partiake. Ndërsa të gjithë pjesëmarrësit theksuan se ishte respektuar pragu prej 40 përqind dhe shprehën kënaqësinë e tyre të përgjithshme të procesit dhe me pozicionimet e tyre në listat e kandidatëve, ato pranuan se sfidat kryesore dhe pengesat që i kanë ballafaquar në procesin e tyre të përzgjedhjes buronin nga kalkulimet politike brenda organeve qendrore dhe ekzekutive të udhëheqësisë së tyre partiake, negociatat brenda partisë apo me partitë e koalicionit për vendet në listën e përbashkët dhe dominimit mashkullor gjatë marrjes së vendimeve përfundimtare se kush do të jetë në listë dhe si do të jetë i pozicionuar.

<sup>20</sup> Kandidati i katërt grua për kryetare të komunës së Kisella Vodës u përcaktua nga partia Integra, por kandidatura e saj nuk u konfirmua.



### 2.3. Tavani i qelqit i lidershipit

Studimi i mëparshëm krahasimtar i kuotave gjinore i v. 2017<sup>21</sup> konstatoi se “tranzicioni nga sistemi politik i partisë komuniste në demokracinë parlamentare përfundoi në krijimin e partive ideologjikisht të ndryshme të udhëhequra nga parti autokratike, ekzekutive të dominuara nga meshkujt”. Studimi vërejti se “ndryshimi ideologjik” që ndodhi në këtë periudhë “ishite veçanërisht i shquar përmes ringjalljes politike të ndarjes tradicionale të roleve gjinore dhe stereotipeve kulturore konservatore”. Kjo pasqyrohet në përqindjen e grave në postet udhëheqëse në partitë politike. Kështu, që nga prilli i v. 2021 ekzistojnë 63 parti politike të regjistruara në Maqedoninë e Veriut, prej të cilave 22 përfaqësohen në kuvend,<sup>22</sup> dhe vetëm tre nga këto parti politike kanë një grua udhëheqëse.<sup>23</sup>

21 Nacevska, E., dhe Lokar, S. (2017). Efektiviteti i kuotave gjinore në Maqedoni, Serbi dhe Kroaci. Teorija in Praska, 54(2), 394–412: f. 396. Në dispozicion në [https://www.researchgate.net/profile/Elena-Nacevska/publication/317224845\\_The\\_effectiveness\\_of\\_gender\\_quotas\\_in\\_Macedonia\\_Serbia\\_and\\_Croatia/links/5be214674585150b2ba308a7/The-effectiveness-of-gender-quotas-in-Macedonia-Serbia-and-Croatia.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Elena-Nacevska/publication/317224845_The_effectiveness_of_gender_quotas_in_Macedonia_Serbia_and_Croatia/links/5be214674585150b2ba308a7/The-effectiveness-of-gender-quotas-in-Macedonia-Serbia-and-Croatia.pdf)

22 Kuvendi përbëhet nga koalicioni VMRO-DPMNE, duke grupuar gjashtë parti politike, koalicioni i LSDM-së, me 7, BDI, PDSH, E majta, Aleanca për Shqiptarët, Alternativa, Besa, Bashkimi Demokratik, Rilindja Demokratike e Maqedonisë dhe Partia Liberal Demokratike. Prej 41 partive që nuk janë të përfaqësuar në kuvend, 24 janë në marrëveshje koalicioni me njërin nga partitë kryesore politike (12 me VMRO/DPMNE Rilindja dhe 12 me SDSM Ne mundemi.

23 Tre partitë politike janë DOM, PEP21, dhe Zëri i Maqedonisë.

Niveli i ulët i përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e strukturave të partive politike në vend është vërtetuar më tej në raportin e v. 2020 në “Dhuna ndaj grave në partitë politike”.<sup>24</sup>

Si ruajtës të portës për aspirantët politikë, partitë politike po luftojnë në përpjekjet e tyre për të arritur përfaqësim të barabartë në organet e brendshme të organizatave: Komiteti ekzekutiv i VMRO-DPMNE -së ka gjithsej 25 anëtarë, prej të cilëve pesë janë gra. Organi më i lartë i LSDM-së, Këshilli ekzekutiv, përbën 16 anëtarë 16 prej të cilëve nëntë janë gra. Organi më i lartë i NSDP-së, Këshilli ekzekutiv nga 21 anëtarë, tetë janë gra. Këshilli ekzekutiv i LDP-së përbën 18 anëtarë, prej të cilëve katër janë gra. Organi më i lartë i partisë BESA është Kryesia qendrore, e cila ka 24 anëtarë, prej të cilëve gjashtë janë gra. Nga tetë postet kyçe kryesuese në Aleancë, dy janë të grave. Kryesia qendrore e PDSH-së numëron 30 anëtarë, prej të cilëve shtatë janë gra. BDI ka përfaqësimin më të ulët të grave në kryesinë e saj qendrore, pasi katër nga 40 anëtarë janë gra. DOM-i udhëheq partitë politike në përfaqësimin e gruas, sepse 11 nga 19 anëtarë të Këshillit ekzekutiv janë gra.

Ndonëse rritja e lidershipit të dukshëm të grave me siguri që do të nxitë përfshirjen më të mad-

24 “Dhuna ndaj grave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut”, nga Fito me gratë, Shkup, 2020; faqet 10 dhe 11; në <https://www.ndi.org/sites/default/files/Win%20with%20Women%20VAW-PP%20Assessment%20Report%20ENG.pdf>



he të grave në partitë politike dhe rolin e tyre në zhvillimin e politikave, manifesteve dhe orientimeve partiake, mbesin sfidat dhe pengesat domethënëse për përparimin e grave brenda partive politike në Maqedoninë e Veriut. Për shembull, raporti i v. 2021 OSBE/ODIHR Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ) vërejti se “shumica e partive politike [të takuara nga ODIHR MVZ] nuk kanë mekanizma të brendshëm efektivë të promovimit dhe nuk i angazhojnë anëtarët e tyre gra në zhvillimin e tyre”. Raporti rekomandoi se partitë politike “duhet të ndërmarrin hapa të mëtejme për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore dhe në vendimmarrjen e brendshme politike”.

Një raport analitik i v. 2016 i Komisionit për barazi gjinore i Këshillit të Evropës mbi raundin e tretë të ndjekjes dhe zbatimit të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, Rec (2003)3, mbi pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë Maqedoninë e Veriut, arriti në përfundim se “përqindja e grave në udhëheqjen ekzekutive partiake ose si anëtare dhe kandidatë partiake mbeti larg objektivit minimal prej 40% përqind”. Përgjithësisht, raporti përfundoi se “partitë politike mbetën organizata të dominuara nga meshkujt, kryesisht të drejtuara nga meshkujt”. Më tej, raporti vërejti se përqindjet e grave në mesin e drejtuesve të partisë dhe anëtarëve të partisë

përafërsisht ishin në raport me përqindjet më të larta të grave në mesin e kandidatëve zgjedhorë për zgjedhjet kombëtare:<sup>25</sup>

**Rregulloret e miratuara në lidhje me partitë politike ose të miratuara nga to për të përmirësuar praninë e grave dukej se jepnin rezultate të përziera. Rezultatet më të mira kanë dalë nga kuotat partiake për zgjedhjet ose për organet e brendshme partiake vendimmarrëse. Kjo përputhet me konstatimet në pjesët e tjera të raportit: kur partitë miratojnë vullnetarisht masa të fuqishme për të përmirësuar baraspeshën gjinore, ato janë zakonisht (shumë) efektive.**

Ende nuk ekzistojnë rregulla të zbatueshme lidhur me baraspeshën gjinore brenda strukturave partiake, përderisa përvojat e mëparshme të kuotave vullnetare partiake kanë rezultuar të pasuksesshme.<sup>26</sup> Për këtë shkak, ndoshta vëndi duhet të konsiderojë vendosjen e legjislacionit me qëllim që t'i obligojë partitë politike që të ndjekin përfaqësimin e grave në strukturat e tyre, të zbatojnë revizione gjinore dhe publikisht t'i shpalosin konstatimet e revizionit të tyre.

<sup>25</sup> Council of Europe (2016). Balanced participation of women and men in decision-making. Analytical Report of the Gender Equality Commission: 2016 data. Available at: <https://rm.coe.int/analytical-report-data-2016-/1680751a3e>

<sup>26</sup> Nacevska, E., dhe Lokar, S. (2017). Efektiviteti i kuotave gjinore në Maqedoni, Serbi dhe Kroaci. *Teorija in Praska*, 54(2), 394–412:

# 3. Barazia gjinore dhe realizimi i zgjedhjeve lokale të v. 2021

Ndërmjet viteve 2017 dhe 2021, KSHZ-ja ka funksionuar në tre përbërje dhe kohëzgjatje të mandatit. Edhe pse kodi zgjedhor përcakton se “kryetari dhe anëtarët e organeve zgjedhore i zbatojnë detyrat e funksionit të tyre në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe përgjegjësi”, këto ndryshime të shumta strukturore tregojnë mungesën e thellë politike të vizionit për udhëheqjen e KSHZ-së nga ana e kuvendit. Kjo mungesë e stabilitetit mund të pengojë vendosjen e qëllimeve afatgjate, siç janë barazia gjinore dhe integrimi gjinor si dhe zbatimi i këtyre qëllimeve nga njësitë teknike të administratës zgjedhore.

Organet zgjedhore gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore i karakterizon kujdesi i madh ndaj baraspeshës gjinore në përbërjen e subjekteve relevante në të gjitha nivelet. Kjo përfshin ndërmarrjen e revizioneve të rregullta për të identifikuar çdo problem dhe zhvillimin e një plani të veprimit, të përshtatshëm për të trajtuar çështjet gjinore. Planin e veprimit gjinor duhet të siguroj nominimin e personave përgjegjës (focal points) që do t'i përkushtohen çështjeve gjinore dhe përdorimit të rregullt të analizës gjinore në çështjet lidhur me politikën dhe zgjedhjet, si dhe zhvillimin e proceseve të brendshme administrative. Mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik është një detyrë thelbësore për të siguruar përfshirjen gjinore në organet zgjedhore, sepse mundëson ndjekjen e vazhdueshme, raportimin dhe analizën.

## 3.1. Përbërja e administratës zgjedhore

Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut realizohen nga një sistem tre nivelesh të organeve zgjedhore (OZ):<sup>27</sup> KSHZ-ja; 80 Komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit; dhe 3,480 Këshilla zgjedhorë (KZs).<sup>28</sup> KSHZ ka përgjegjësinë për realizimin e plotë të zgjedhjeve, përdorisa 80 KKZ-të, secila e përbërë prej pesë anëtarësh dhe pesë zëvendës të zgjedhur në mënyrë të rëndomtë nga radhët e nëpunësve shtetërorë, kanë përgjegjësi për përmblidhjen dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore në komunën e tyre. KKZ-të gjithashtu kanë për detyrë të emërojnë dhe trajtojnë anëtarë të KZ-ve në nivelin më të ulët të piramidës së administratës zgjedhore. 3,480 KZ-të janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave ditën e zgjedhjeve në vendvotime. Këto organe përbëhen nga pesë anëtarë dhe pesë zëvendës, nga të cilat një anëtar propozohet nga partitë në pushtet, një nga partitë opozitare, dhe tre të zgjedhur në mënyrë të rëndomtë nga radhët e nëpunësve shtetërorë. Në v. 2006<sup>29</sup>, ndryshimet në kodin zgjedhor futën parimin e përfaqësimit të duhur dhe të drejtë, duke imponuar kuotën gjinore e cila kërkon më pak se 30% të secilës gjini të përfaqësohet në të gjitha organet zgjedhore.<sup>30</sup>

27 Nenet 17–40 të kodit zgjedhor për përbërjen dhe kompetencat e tri niveleve të administratës zgjedhore.

28 Për votimin jashtë vendit, krijohen 46 KZ shtesë në zyrat diplomatike dhe konsullore.

29 Kodi zgjedhor i RM v. 2006, Neni 21, paragrafi 3, Neni 64 paragrafi 5 dhe ndryshimet nga 2015 neni 21 dhe 64 si më lart.

30 Neni 21 i Kodit zgjedhor.

Asnjë grua nuk është përcaktuar për kryesinë e KSHZ-së që nga formimi i saj si organ i përherëshëm. (Kompetencën për përcaktimin e kësaj pozite e ka partia kryesore opozitare /koalicioni.) Reformat në menaxhimin zgjedhor të cilat nisën shtatë vitet e kaluara që të kufizohet ndikimi i partive politike ndaj KSHZ-së<sup>31</sup> çuan në ringjalljen e formulës së mëparshme. Në përbërjen aktuale të KSHZ-së, vetëm dy gra janë emëruar si komisionere gjë që nuk respekton parimin e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë dhe bie në kundërshtim me nevojën për përfaqësim të baraspeshuar gjinor në organet zgjedhore siç përcaktohet në nenin 21 të Kodit zgjedhor. Kuvendi, me procedurën vërtetuese të KSHZ-së që parasheh dy të tretat e shumicës së votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, i dha një goditje të madhe parimeve të sundimit të ligjit dhe barazisë gjinore.

Në v. 2017 dhe v. 2021, vëzhguesit e zgjedhjeve të OSBE/ODIHR vunë re se përbërja e nivelit të ulët të organeve zgjedhore në vend përputhej me kërkesat e Kodit zgjedhor për përfaqësimin gjinor dhe etnik. Megjithatë, në praktikë 13 nga 81 KKZ në 2017 nuk e plotësuan kuotën e përfaqësimit, e cila preku në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë.<sup>32</sup> Në zgjedhjet e v. 2021, gratë kryesuan 39 KKZ të tjera (p.sh. 49% e të gjitha KKZ-ve). Megjithëse, KSHZ-ja nuk i publikoi të dhënat e zbërthyer në bazë të seksit biologjik në përbërjen e organeve zgjedhore, i vetmi tregues vjen nga misioni i vëzhgimit OSCE/ODIHR, që vuri re se gratë kryesuan rreth 55 përqind të KZ-ve dhe përfaqësuan 47% të KZ-ve përgjithësisht në vendvotimet e vëzhguara. Në aspektin pozitiv, baraspesha gjinore tejkalon pragun e kërkuar për përbërjen e

nivelit të ulët të administratës zgjedhore, mandati i mundshëm i shkurtër si dhe shkelja e kërkesës së kuotës së përbërjes për postet e komisionarëve nuk janë një kontekst i favorshëm për mundësinë dhe interesin për kyqjen strategjike të perspektivës gjinore brenda aktiviteteve të KSHZ-së.

### 3.2. KSHZ-ja dhe kyçja e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore

Përkundër ndërmarrjes së disa iniciativave të KSHZ-së, veçanërisht që disa nga fushatat e saj t'i drejtojnë në ndërgjegjësimin dhe edukimin e votuesve të votueset gra, Plani strategjik i KSHZ-së për v. 2017–nuk përmend në veçanti çështjet gjinore. Megjithatë, Plani strategjik i KSHZ-së për v. 2021–2024 e ka kyçur integrimin e aspekteve gjinore në funksionimin e brendshëm të KSHZ-së dhe në aktivitetet. Plani i veprimit për barazinë gjinore i KSHZ-së, i miratuar në v. 2021, dukshëm orientohet në krijimin e sistemit për zhvillimin profesional dhe të karrierës bazuar në parimet e transparencës, përfaqësimit të ndershëm dhe barazisë gjinore, zhvillim e programit dhe planit të trajnimit për anëtarët dhe stafin e KSHZ-së duke u përqendruar në barazinë gjinore dhe mbledhjen e publikimit e statistikave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik në të gjitha fazat e aspekteve zgjedhore. Lidhur me rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të këtylla, UNWOMEN-i konstatoi si më poshtë:

Të dhënat e zbërthyer në bazë të seksit biologjik në një rresht pikash janë të dobishme për organet zgjedhore që t'i analizojnë, raportojnë dhe përdorin në vendimet e politikave dhe planifikimit. Duke e njohur këtë zbërthim gjinor të të regjistruarve në listën e zgjedhësve, të votuesve në ditën e zgjedhjeve dhe të stafit në të gjitha nivelet, është thelbësore që të mundësohet vlerësimi i baraspeshës gjinore në zgjedhje si dhe në zhvillimin e politikave të cilat mund të korrigjojnë çdo çekuilibër të identifikuar në pjesëmarrjen dhe qasjen e grave. Vlerësimet e periudhës pas zgjedhore mund të përfitojnë nga analizat dhe raportimi duke përdorur të dhënat e zbërthyer në bazë të seksit biologjik në regjistrim, daljen e votuesve dhe stafin i cili ka punuar në zgjedhje.<sup>33</sup>

31 Ligjvënësi prezantoi ndryshimet kryesore të Kodit zgjedhor në v. 2015 që ndryshuan përbërjen e KSHZ-së nga modeli politik në atë të përzier, duke u shtuar prej shtatë në nëntë anëtarë. Tre anëtarë të KSHZ-së nuk kishin përkatësi politike dhe u zgjodhën me konkurs të hapur, ndërsa gjashtë anëtarët e tjerë pasqyruan përbërjen politike të kuvendit. Mandati pesë vjeçar i anëtarëve jo partiakë ishte i mbrojtur në mënyrë të arësyeshme, ndërsa të përcaktuarit e partisë duhej të ndërroheshin pas ndryshimeve të v. 2017 për të harmonizuar përbërjen e KSHZ-së me përbërjen aktuale të kuvendit. Në v. 2020, zgjedhjet e parakohshme parlamentare u administruan prej shtatë anëtarëve të KSHZ-së me tre gra, duke përfshirë nënkryetaren. Mandati i KSHZ-së që atëherë është zgjatuar në dy raste: së pari në nëntor të v. 2018 deri në dy vjet; dhe më pas, në bazë të dekretit të qeverisë së datës 21 mars 2020, deri në gjashtë muaj nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare të v. 2020. KSHZ-ja në përbërjen e saj aktuale prej shtatë anëtarësh u emërua në janar të v. 2021 me një mandat maksimal dy vjeçar. Amendamentet e 15 shtatorit 2021 e zgjatën mandatin e KSHZ-së për pesë vjet. Megjithatë, mandati edhe i komisionerëve edhe i udhëheqësit të shërbimeve profesionale i është nënshtruar koalicionit të shumicës së kuvendit.

32 OSBE/ODIHR EOM Raporti përfundimtar për Zgjedhjet lokale 2017.

33 UNWOMEN, Proceset përfshirëse zgjedhore, 2015, faqe 45 ; Në dispozicion në <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/7/inclusive-electoral-processes>

Prodhimi i të dhënave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik dhe qasja në këto të dhëna rregullohet më përgjithësisht nga korniza normative. Plani kombëtar i veprimit i barazisë gjinore 2018–2020<sup>34</sup> i cakton KSHZ-së përgjegjësinë për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik për daljen në zgjedhje, listat e kandidatëve, dhe mandatet e fituara në nivel lokal dhe kombëtar. Ekziston po ashtu obligimi ligjor në të gjitha institucionet shtetërore për t’u ofruar të dhënat e zbërthyer në bazë të seksit biologjik, siç përcaktohet në nenin 18 të Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat. Edhe pse Plani i veprimit gjinor i KSHZ-së gjithashtu parashihet përmirësime në mbledhjen e të dhënave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik, të vetmet të dhëna të tilla, të pranishme në faqen e KSHZ-së, kanë të bëjnë me listat e kandidatëve. Pavarësisht vullnetit politik, për të mbledhur të dhëna të tilla, mbledhja dhe analiza e duhur e statistikave gjinore kërkon përmirësime në disa nga forularë kryesorë zgjedhore, të cilat shërbejnë si mjete kryesorë të mbledhjes së të dhënave.

Duhet të ofrohet trajnim për komisionarët e KSHZ-së dhe stafit menaxhues mbi rëndësinë dhe modalitetet e perspektivës gjinore në zgjedhje për të ripërtërur përkushtimin e KSHZ-së të politikave të barazisë gjinore dhe të lehtësojë zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin strategjik dhe Planin e veprimit gjinor. Këto trajnime dhe mbështetja teknike duhet të japin rezultate konkrete siç janë prodhimi i udhëzimeve për mbledhjen e statistikave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik.

### 3.3. Vlerësimi i zbatimit të kuotës së përcaktuar gjinore zgjedhore

Zgjedhjet komunale të v. 2017 ishin zgjedhjet e para lokale që u mbajtën në vend në të cilat u zbatua kuota gjinore e përforcuar me dy kërkesat e vëna. Megjithatë, KSHZ-ja në fund i ndryshoi udhëzimet e miratuara më parë të cilat e lehtësonin respektimin e kuotës gjinore të zmadhuar.<sup>35</sup> Si rezultat i këtij ndryshimi, 46 KKZ regjistruan 9 lista (5% e numrit të përgjithshëm të listave) me

më pak se 40 përqind candidate gra. Njëmbëdhjetë lista nuk kishin gra në çdo vend të tretë dhe gjashtë lista nuk kishin gra në çdo vend të dhjetë.

Megjithëse udhëzimi i KSHZ-së u ndryshua në gusht të v. 2021 dhe grafikonët e saktë u rifutën, mbetën sërish disa çështje të pazgjidhura. Udhëzimi zgjodhi të nxjerrë në pah rezultatin më pak të favorshëm të renditjes gjinore duke vënë re shprehimisht se, “Nëse kandidati i katërt i seksit më pak të përfaqësuar vendoset në vendin e 10-të të listës së kandidatëve, atëherë kandidati i pestë i seksit më pak të përfaqësuar vendoset në një nga vendet 11 ose 12 të listës së kandidatëve.”<sup>36</sup> Situatat në të cilat kandidatja e katërt-grua ndodhet në të gjitha vendet tjera që ka në dispozicion (nga 1 në 10) nuk janë të veçuara si të tilla. Ky paragjykim shërben për të nxitur tashmë modelin e dokumentuar të ndjekjes me vendosmëri të renditjes më të ulët të mundshme gjinore dhe për këtë shkak duhet të hiqet.

Siç është theksuar në këtë analizë të veprimtarisë së kaluar të KSHZ-së, ekziston nevoja për një përkushtim më të madh të barazisë gjinore nga ana e KSHZ-së.

34 [https://drive.google.com/file/d/16EGLPg8bJzPnu0\\_OpiYam7Cue0pj2Yws/view](https://drive.google.com/file/d/16EGLPg8bJzPnu0_OpiYam7Cue0pj2Yws/view)

35 Burimi: OSBE/ODIHR Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Raport-Raport përfundimtar, Zgjedhjet komunale 15 tetor dhe 29 tetor 2017, f. 11 <https://www.osce.org/files/f/documents/d/0/367246.pdf>

36 Udhëzimet në mënyrën dhe procedurën e parashtrimit, pranimit dhe konfirmimit të listës së kandidatëve për zgjedhjet lokale, gusht 2020, në <https://www.sec.mk/upatstvo-za-nachinot-i-postapkata-za-podnesuvanje-priem-i-potvrduvanje-na-kandidatski-listi-za-lokalni-izbori-2021/>

# 4. Ndërgjegjësimi publik dhe mbështetja e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore e politike

Votuesit janë palët e prekura vendim-marrëse në çdo proces zgjedhor. Një nga objektivet strategjik të anketës së zbatuar në këtë studim ishte që të konstatohet niveli i ndërgjegjësimit publik rreth mbështetjes së pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike. Përmes një tufe pyetjesh të synuara, sondazhi shpalosi dhe dokumentoi perceptimet publike rreth kandidaturës së grave dhe rolit të gruas në arenën politike. Duke arritur mirëkuptimin më të mirë të qëndrimit të zgjedhësve ndaj barazisë gjinore do të mundësohet për një përpjekje më të synuar përfaqësimi dhe mbështetje të reformave zgjedhore si dhe barazi më të madhe, parti politike dhe procese gjithëpërfshirëse, si dhe programim sa më efektiv të aktiviteteve të përshtatura.

## 4.1. Interesi dhe perceptimi i qytetarëve për praninë e grave në proceset politike dhe zgjedhore

Megjithëse zgjedhjet lokale ishin zgjedhjet “më të afërta” për qytetarët, vetëm 45.3 përqind e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut deklaruan se ishin ose “shumë” ose “disi” të interesuar në politikën lokale. Një e katërta e të intervistuarve raportuan se i kishin ndjekur aktivisht zgjedhjet e fundit lokale, përdorisa 44 përqind vetëm pjesërisht ndoqën zgjedhjet dhe një e treta e mbetur nuk i ka ndjekur fare.

Dalja e përgjithshme e votuesve për raundin e parë të zgjedhjeve lokale 2021 ishte 51.44


përqind dhe perceptimet e qytetarëve të anketës tregojnë se niveli i interesit në politikën lokale në mbarë vendin është rreth pesëdhjetë përqind. Megjithatë, kur u pyetën që të vlerësojnë interesin e tyre për gratë dhe pjesëmarrjen e tyre politike në zgjedhjet lokale dhe parlamentare, skema është e kundërt 56.1 përqind e të anketuarve të interesuar, kundrejt atyre 42.7.

Zbërthimi i të dhënave të anketës në bazë të gjinisë tregon se femrat e anketuara janë dukshëm më të interesuara për politikën se të anketuarit meshkuj, ndërsaq niveli i lartë arsimor ndërmjet meshkujve dhe femrave të anketuara lidhet gjithashtu me një interes të lartë të politikës dhe në pjesëmarrjen e grave në politikë. Në bazë të kësaj mund të argumentohet se rritja e kandidaturave të grave për postet e këshilltareve dhe kryetareve të komunave mund të rezultojë me një rritje të interesit të politikës lokale dhe mundësisht dhe një dalje më të madhe. Më tej, dokumenton një pabarazi të dukshme ndërmjet interesave dhe aspiratave të votuesve dhe një sistemi zgjedhor i cili nuk promovon plotësisht pjesëmarrjen e grave.

Për të vlerësuar nivelin e ndërgjegjësimit rreth pranisë së gruas në sferat zgjedhore dhe politike, të anketuarve iu kërkua të renditin praninë e grave në 12 poste të ndryshme politike dhe/ose profesionale. Tri poste që qytetarët i perceptonin si më pak të hapura për gratë ishin ato të kryetarit të komunës, të ministrit dhe të liderit të partisë politike. Tri postet e perceptuara si më të qasshme për gratë ishin ato të anëtarit të partisë, të nëpunësit shtetëror dhe të gazetarit.

**Figura 5**

Interesi i të anketuarve në pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet lokale dhe parlamentare




Deficiti i grave në postet udhëheqëse politike perceptohet qartë nga qytetarët. E përdherisa të dhënat për zgjedhjet lokale të v. 2021 tregojnë një rritje të butë të kandidaturave të grave krahasuar me zgjedhjet e v. 2017, kjo rritje nuk ishte dhe aq domethënëse që ta perceptonin qytetarët.

Të pyetur për të vlerësuar numrin e mëparshëm dhe aktual të grave të zgjedhura për kryetare të komunave, dy të treta e të anketuarve saktësisht e vlerësuan këtë shifër si nën 10 prej gjithsej 81 kryetarëve në zgjedhjet lokale të mëparshme. Megjithatë, një e treta e të anketuarve ose nuk ishin në gjendje t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje

**Figura 6**

Interesi i të anketuarve në pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet lokale dhe parlamentare





**Tabela 1**

Përqindja e kandidateve gra kryesuese të listës dhe për kryetare të komunës-Zgjedhjet lokale 2017 dhe 2022

Kandidatet gra	2017	2021
Numri i listave kryesuese nga gratë	14%	19%
Për kryetar të komunës	5.2%	8%

**Tabela 2**

Numri i grave të zgjedhura për kryetare të komunave në katër zgjedhjet e fundit lokale

Viti	Numri i kryetareve gra të zgjedhura
2009	0
2013	4 (5%)
2017	6 (7.83%)
2021	2 (2.5%)

(23.7% e të anketuarve), ose e mbivlerësuan numrin e grave - kryetare të komunave mbi 10 (8.1% e të anketuarve).

Rezultatet e anketës theksuan se është vështirë për gratë të arrijnë poste të larta politike në Maqedoninë e Veriut. Ky perceptim ndahet pothuajse nga dy të tretat e të anketuarve meshkuj dhe

femra. Këto konstatime së bashku me të dhënat e paraqitura më lart mund të interpretohen si një tregues se edhe përkundër mungesës së qasjes së grave në postet udhëheqëse më së shumti është perceptuar nga qytetaria, një pjesë e konsiderueshme e popullatës mbetet e pavetëdijshme për përfaqësimin e ulët të grave në postet e kryetarëve të komunave në mbarë vendin.

## 4.2. Vlerësimi i perceptimit publik të kuotës gjinore ekzistuese

Anketa përfshiu një seri pyetjesh për të shpalosur perceptimet e qytetarëve për kuotën gjinore, duke përfshirë pyetjen se a pajtohen ata me deklaratat e mëposhtme (duke u nisur nga parimet e përgjithshme në deklarata të veçanta rreth kuotës propozuese legislative në praktikë): “mundësi të barabarta për gratë dhe burrat”, “barazi e garantuar ndërmjet grave dhe burrave si qytetarë”, “40% e pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet e qeverisë”, dhe, më konkretisht, “në listën me 10 kandidatë, 4 nga njëri seks dhe 6 nga seksi tjetër”.

Ndërsa niveli i pajtueshmërisë së të anketuarve me katër deklaratat ishte në përgjithësi shumë i lartë, rezultatet tregojnë një diferencë prej 20 përqind ndërmjet niveleve të pajtueshmërisë me deklaratat që shprehin parimin e përgjithshëm të barazisë gjinore krahasuar me deklaratat që propozojnë një formulë të kuotës së veçantë, me 86.2 përqind duke u pajtuar me parimin më të përgjithshëm dhe 67.6 përqind duke u pajtuar me formulën. Të dhënat e zbërthyer në bazë të seksit biologjik lidhur me këto pyetje tregojnë se meshkujt dhe femrat të anketuar afërsisht



pajtoheshin me deklaratat e përgjithshme rreth barazisë (më pak se 10% diferencë) se sa në pajtueshmërinë e tyre me formulën e kuotës, me ç'gjë gratë e mbështesin më shumë këtë kuotë nga burrat (më shumë se 10% diferencë).

Edhe pse një e treta e të anketuarve nuk pajtohen me formulën e kuotës së propozuar, shtatë prej 10 mbështesin rritjen e hapësirës për gratë në politikë në nivel lokal. Prej tyre që nuk pajtohen me nevojën e përpjekjeve që të rritet pjesëmarrja e grave në politikë në nivel lokal, pesë shprehimisht nuk u pajtuan dhe një nga 10 prej tyre ose u përgjigj "nuk e di" ose refuzoi të përgjigjet.



**“Kuota gjinore është instrumenti matës pozitiv që ka për qëllim të përshpejtojë arritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të baraspeshuar gjinor duke vendosur proporcionin e definuar (përqindjen) ose numrin e vendeve a mandateve që duhet t’i mbushin, a t’ju ndahen grave dhe/ose burrave, përgjithësisht nën rregulla dhe kritere të caktuara.”**

*Instituti Evropian për Barazi Gjinore*

Përderisa gjysma e të anketuarve u pajtuan se kandidimi i grave për poste në zgjedhjet lokale ishte një zhvillim pozitiv dhe i domosdoshëm, 24.1 e vlerësuan këtë zhvillim si një synim kryesisht për t’i bërë partitë politike më tërheqëse për votuesit. Pjesa e mbetur prej 18 të të anketuarve e perceptuan rritjen e numrit të grave që kandidojnë për këto poste si diçka të imponuar me ligj. Niveli i “rezistencës” së tillë publike ndaj përdorimit të kuotave gjinore në zgjedhje mund të vlerësohet si një pasqyrim i këndvështrimeve ndërmjet 25 dhe 33 përqind të trupit votues.

Është e rëndësishme se kjo rezistencë kryesisht shprehet nga burrat. Vetëm 56.6 përqind e qytetarëve meshkuj, shprehin mbështetjen për rritjen e hapësirës së grave në politikë në nivel lokal, krahasuar me 78.9 përqind të qytetareve femra në favor të kësaj. Mospërputhja e njëjtë prej 20 përqind u vërejt ndërmjet të anketuarve meshkuj e femra në lidhje me perceptimet e grave që kandidojnë për poste, ku 41 përqind e meshkujve të anketuar e vlerësojnë këtë si një zhvillim pozitiv, kundrejt 61.1 përqind të femrave me po këtë opinion.

Zbërthimi i këtyre të dhënave sipas nivelit arsimor, përkatësisë etnike dhe moshës tregon mëtej se ata që kanë më pak gjasa të mbështesin rritjen e hapësirës për gratë në politikën lokale i përfshin kryesisht njerëzit vetëm me arsim fillor, në mesin e etnive jomaqedonase mbi 55 vjeç. Këto shënime u vërtetuan nga analiza e profileve e të anketuarve të cilët shprehën mbështetjen për mundësi të barabarta, por jo edhe për formulën konkrete të zbatimit të saj si kuotë gjinore zgjedhore.

Kjo analizë vërteton se edhe pse inkorporimi i kuotës gjinore është vërtetuar si formë e suksesshme për të përmirësuar përfaqësimin numerik të grave si në kuvend, ashtu edhe në këshillat lokale, përmbledhja tabelore e të dhënave të kryqëzuara të anketës në bazë të seksit tregon se vetëm 41 përqind e meshkujve të anketuar i perceptojnë gratë që kandidojnë për poste në zgjedhjet lokale si një zhvillim pozitiv dhe të domosdoshëm. Çuditërisht, 52.4 përqind të meshkujve të anketuar shfaqën perceptimin se gratë që kandidojnë për poste ishte diçka ose “e detyruar” për t’i bërë partitë politike më tërheqëse ose diçka që është e imponuar me ligj.

**Tabela 3**

**Përqindja e grave të zgjedhura në kuvend dhe në këshillat lokale**

	2012-2014	2014-2018	2016-2020	2020-
% të grave në kuvend	34,1%	34,9%	37,5%	39,17%
	2009	2013	2017	2021
% të grave në këshillat lokale	27%	30%	33%	36,4%



### 4.3. A ka tregues të votës parapëlqyese për gratë?

Në pyetjen nëse do të votonin për një kandidat grua ose burrë nëse të dy kandidatët do të kishin interes të njëjtë, 44 përqind e të anketuarve deklaruan se do të votonin për kandidaten grua, 25 përqind thanë se do të zgjedhnin kandidatin burrë dhe pjesa e tretë e mbetur ose deklaruan se “nuk e dinë” cilin kandidat do ta kishin zgjedhur ose nuk pranuan të përgjigjeshin. Ndarja e këtyre përgjigjeve në bazë të seksit vërteton se gjinia llogaritet me një mospërputhje të lartë në këto të dhëna, me 63.5 përqind të femrave të anketuara duke zgjedhur kandidatet gra kundrejt 42.2 përqind të meshkujve të anketuar duke zgjedhur kandidatin burrë. Analiza e mëtejshme e të dhënave tregon se femrat e anketuara ishin më të vendosura në përgjigjen e tyre ndaj kësaj pyetjeje, me 23 përqind duke shprehur pasiguri për cilin kandidat do të kishin votuar krahasuar me 32.2 përqind të meshkujve të anketuar duke u përgjigjur në këtë mënyrë. Vota parapëlqyese për gratë, respektivisht “Unë do të zgjidhja kandidaten grua sepse unë jam grua” u rendit e 11-ta nga 24 arsyet e propozuara për të zgjedhur kandidatin po aq të kualifikuar.

Anketa kërkoi që të anketuarit të përzgjedhin midis disa grupeve të kandidatëve me karakteristika dalluese ato aspekte që do t'i nxisnin të votojnë për një listë në vend të tjetrës. Dy karakteristikat që shumica e të anketuarve zgjedhën të

votonin u ndërlidhën me afërsinë e kandidatëve, përfshirë “njerëzit që i njeh” dhe “përfaqësuesit e komunitetit tuaj lokal”. Karakteristika e tretë për të cilën qytetarët thanë se do t'i zmadhojë gjasat për të votuar një grup të caktuar ishte mosha e kandidatëve, me parapëlqim të qartë për kandidatët më të rinj. Për dallim nga afërsia dhe mosha, gjinia nuk u konsiderua kriter vendimtar në përzgjedhjen e listave parapëlqyese nga të anketuarit, duke u renditur e katërta në karakteristikat e parapëlqyera të grupeve, me numër më të madh të të anketuarve duke deklaruar se prania e grave në listë nuk ka pasur ndikim në zgjedhjen e tyre të parapëlqyer.

Në pyetjen cilën nga dhjetë kriteret e mundshme do ta kishin aplikuar në zgjedhjen e kandidatit, të anketuarit e radhitën gjininë e kandidatit në vendin e shtatë, duke i dhënë përparësi shumë më të madhe arritjeve të kandidatit në të kaluarën dhe formimin social, arsimor dhe profesional të tij/saj. Njohuritë e të anketuarve për kandidatin dhe reputacioni i tyre ishin gjithashtu të ranguara më lartë nga gjinia në zgjedhjen e kandidatit nga të anketuarit.

Këto rezultate tregojnë se niveli i lartë i interesimit dhe mbështetjes së grave në Maqedoninë e Veriut për pjesëmarrje më të madhe të grave në proceset zgjedhore dhe politike nuk përkthehet në votë parapëlqyese nga gratë votuese për gratë candidate.

# 5. Barrierat dhe pengesat kryesore për pjesëmarrjen e grave

**A**nketa u kërkoi gjithashtu të anketuarve të renditin ndikimin e një liste të caktuar barrierash për pjesëmarrjen efektive të grave në proceset politike dhe zgjedhore. Sipas rëndësisë, barrierat e identifikuara nga të anketuarit ishin si më poshtë:

- barra e dyfishtë dhe ndarja joproportionale e punëve amvisërore si dhe lindja e fëmijëve;
- rolet tradicionale gjinore, stereotipet dhe qëndrimet e normat diskriminuese;
- mungesa e mbështetjes partiake dhe përjashtimi nga strukturat vendimmarëse të partisë;
- gjuha ofenduese onlajn gjatë fushatave partiake;
- perceptimi i politikës si “e ndyrë”;
- mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare për t’u konsideruar anëtarë kuptimplotë të partive politike;
- mungesa e përvojës politike,
- mungesa e fondeve për fushatën,
- mungesa e shtrirjes mediatike;
- stereotipet dhe paragjykimet me bazë gjinore në portretizimin e grave në media;
- mungesa e trajnimit, duke përfshirë të folurit publik;
- mungesa e mbështetjes së forumit/degës së grave;
- mungesa e mbështetjes nga organizatat qytetare të grave aktive në fushën e pjesëmarrjes politike dhe dhuna brenda e jashtë partisë.

Vlerësimi që iu caktua këtyre faktorëve nga të anketuarit lëvizte nga 74 në 63.9 përqind, që tregon se ata i konsiderojnë këta faktorë ose si “shumë

të rëndësishëm” ose si “të njëfarë rëndësie”. Nga kjo gjë mund të përfundohet se të gjitha këto barrierat perceptohen se kanë një ndikim mjaft të pavoritshëm në pjesëmarrjen efektive të grave në proceset politike dhe zgjedhore.

## 5.1. Niveli i këmbënguljes, mbizotërimi dhe ndikimi i stereotipeve gjinore

Studimi i mëparshëm mbi qëndrimet gjinore në Maqedoninë e Veriut nga USAID në v. 2019 përfshinte përfundimin e mëposhtëm:


**Në Maqedoninë e Veriut mbizotërojnë normat patriarkale dhe tradicionale shoqërore, duke i vendosur përgjegjësitë e grave së pari në shtëpi. Normat kulturore dhe besimet nuk ndryshojnë gjerësisht sipas rajonit gjeografik, por ato ndryshojnë sipas përkatësisë etnike dhe janë më të theksuara në rajonet rurale. Stereotipet lidhur me kapacitetet ekonomike dhe politike të grave mbeten botërisht të pranuar. Gratë e të gjitha grupeve etnike shprehin mungesë të vetëbesimit që të zhvillojnë aktivitete të cilat devijojnë nga rolet e tyre tradicionale.<sup>37</sup>**

Ndonëse studimi aktual nuk e mohon këtë përfundim si një mbizotërim i përgjithshëm i normave konservatore shoqërore në Maqedoninë e Veriut, analiza e të dhënave të anketës tregon më shumë mbështetje të pjesëmarrjes së grave në proceset

<sup>37</sup> USAID/Maqedoni e Veriut raport i analizës gjinore, i publikuar në korrik 2019.

**Figura 7**

Kriteri kryesor i përdorur për të zgjedhur kandidatin burrë/grua



zgjedhore dhe politike në mesin e popullatës në tërësi se sa mund të pritej, duke pasur parasysh mbizotërimin e normave dhe qëndrimeve të këtila tradicionale. Si për shembull, një shumicë e pakët e meshkujve të anketuar (56.6%) deklaruan mbështetjen e tyre të rritjes së hapësirës për gratë në politikën lokale, ndërsa 78.9 përqind e femrave të anketuara deklaruan një mbështetje të këtille. Arsyeja kryesore e dhënë për një mbështetje të këtille ishte nevoja për barazi gjinore, të drejta të barabarta dhe përparimi i demokracisë. Arsyeja e dytë më e shpeshtë e dhënë për mbështetje të këtille ishte opinioni se nuk ka dallim midis burrave dhe grave dhe se që të dy gjinitë mund të jenë njëjloj të aftë dhe të suksesshëm.

Në lidhje me barrierat e pjesëmarrjes së grave të identifikuar nga të anketuarit në anketë, megjithatë, dy pengesat e konsideruara si më të rëndësishme ishin (i) barra e dyfishtë dhe ndarja jo proporcionale e punëve amvisërore si dhe lindja e fëmijëve që bie te gratë, dhe (ii) mbizotërimi i roleve tradicionale gjinore, stereotipeve si dhe qëndrimeve dhe normave diskriminuese. Këto perceptime mbizotërojnë veçanërisht në rajonet rurale, siç tregohet prej të dhënave të nxjerra nga përmbledhja tabelore e kryqëzuar sipas vendbanimit, me 53.7 përqind e të anketuarve në rajonet rurale i vlerësojnë rolet tradicionale gjinore si një barrierë mjaft të rëndësishme të pjesëmarrjes së grave në politikë, përkundrajt 32.2 përqind e të anketuarve urbanë që e cilësojnë këtë bar-

rierë si mjaft të rëndësishme. Në mënyrë të ngjashme, përdërisa 51 përqind e të anketuarve në rajonet rurale e vlerësuan ndarjen jo proporcionale të grave në punët shtëpiake dhe të qenit prind si një barrierë shumë të rëndësishme të pjesëmarrjes së tyre në politikë, vetëm 37.9 e të anketuarve urbanë e ndanë këtë vlerësim.

Siç u përmend më herët, dy të tretat e 20.8 përqind e të anketuarve të cilët nuk mbështetën rritjen e hapësirës së grave në politikë në nivel lokal ishin meshkujt. Arsyeja kryesore e dhënë për këtë qëndrim ishte opinioni i shprehur se “politika është për burrat, jo për gratë”, që përbën një thënie atërore dhe “territoriale”. Arsyeja e dytë e dhënë për këtë gjykim bazohej në pikëpamjen konservatore dhe tradicionale të roleve gjinore, p.sh. se gratë që marrin pjesë në politikë “nuk do të kenë kohë për punët familjare dhe të amvisërisë”. Paradoksalisht, arsyeja e tretë e përmendur për këtë qëndrim ishte opinioni se burrat janë “më të aftë, më aktivë, më të qëndrueshëm dhe më vendimtarë” se gratë, kur opsioni që renditet numerikisht i treti si një arsye e mos mbështetjes së hapësirës për gratë në politikë është opsioni “nuk e di”.

Nga 24.9 përqind e të anketuarve të cilët deklaruan se do të zgjidhnin kandidatin burrë në vend të kandidatit grua, pavarësisht se të dy kandidatët kishin thirrje të barabarta në aspektet tjera përveç gjinisë, arsyeja kryesore e dhënë për këtë zgjedhje ishte opinioni se burrat janë më të

zgjuar, më të aftë dhe më të shkathët se gratë. Motivet tjera për këtë zgjedhje bazoheshin në pikëpamjen se burrat janë më të guximshëm dhe se burrat kanë më shumë përvojë, njohuri dhe njohje të politikës. Është interesante se cilësitë e njëjta të inteligjencës dhe të shkathtësive u vlerësuan shumë ulët, në vetëm 18 prej 24, në mesin e 478 të anketuarve të cilët thanë se do të zgjedhin gruan kandidatë në vend të burrit, ndryshe nga thirrja e ngjashme.

Analiza e kriterëve që i kanë aplikuar të anketuarit për të zgjedhur kandidatin burrë ose grua zbulon anësinë e qartë gjinore. Përderisa tre kriteret të cilat i identifikuan të anketuarit si më të rëndësishmet në përzgjedhjen e kandidatëve, përkatësisht “arritjet e kaluara”, “prejardhja sociale, arsimore dhe profesionale” dhe “njerëzit që i njoh/u besoj” ishin të njëjta si për kandidatët burra ashtu e dhe për kandidatet gra, paragjykimi gjinor ishte i dukshëm në kriteret tjera. Si për shembull, të anketuarit i konsideruan kriteret e “programit/çështjeve”, “përkatësisë politike” dhe “fushatës zgjedhore” duke qenë diçka më të rëndësishme gjatë zgjedhjes së kandidatëve burra, përderisa gjinia e kandidatit, statusi martesor/familjar dhe pamja fizike u konsideruan disi më të rëndësishme gjatë përzgjedhjes së grave kandidatë.


Në diskutimet e fokus grupeve të zbatuara për këtë studim, gratë kandidatë për t’u zgjedhur

theksuan se gratë në Maqedoninë e Veriut janë të identifikuara fuqishëm me rolet e nënës dhe të bashkëshortes, për këtë gjë përgjithësisht prej tyre pritet t’i kushtojnë më shumë nga koha e tyre dhe prioritetet e tyre për të menaxhuar familjen dhe shtëpinë sesa burrat, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve të tyre nga stresi dhe presionet që vijnë me karrierën politike. Kur u pyetën t’i pasqyrojnë përvojat personale nga fushata zgjedhore, gratë të cilat kandiduan si kandidatë të pavarura ose si kandidatë partiake për këshilltare raportuan se ishin më të sfiduara nga çështjet që kishin të bëjnë me paraqitjen e tyre publike sesa nga sfida që rezultoi nga kombinimi i angazhimit në shtëpi, profesion dhe nga aktivitetet e fushatës. Në mesin e stereotipeve të cilat duhej t’i ballafaqonin si kandidatë ishin pikëpamjet e tipit “politika nuk është për gratë”, “se gruaja udhëhiqet nga emocionet dhe nuk është konsekuente dhe e qëndrueshme në sjelljen e vendimeve” dhe se “gratë nuk janë të guximshme sa duhet dhe të afta për të ndërmarrë vendime të vështira si dhe të udhëheqin proceset politike”.

Të anketuarit po ashtu u lutën të bënin vlerësimin ndërmjet burrave dhe grave kandidatë në bazë të numrit të karakteristikave kryesore në shkallën dalluese semantike që përfshinte tipare të tilla si “i pa përkushtuar” kundrejt “shumë i përkushtuar”, “nuk gëzon mbështetje partiake” kundrejt

**Figura 7**

Karakteristikat kryesore të kandidatëve gra dhe burra



“gëzon mbështetjen partiake”, dhe “udhëheqës jo i mirë” kundrejt “udhëheqës i mirë”. Duke i bërë jehonë perceptimit të lartpërmendur të mungesës së zgjuarsisë, aftësisë dhe kapacitetit për të marrë vendime, analiza e këtyre të dhënave tregon qartësisht se “fuqia për të ndryshuar: dhe për të qenë “një udhëheqës i mirë” lidhet drejtpërdrejt me nivelin e perceptuar së “mbështetjes partiake: për kandidatin. Kështu, përderisa gratë dhe burrat u perceptuan njëllëj si “profesionistë”, “të përkushtuar” dhe “të vendosur”, pikëpamjet se kandidatet gra “nuk gëzojnë mbështetjen e partisë së tyre politike” korrespondonte me perceptimet më pak pozitive të grave kandidate si “udhëheqës të mirë” dhe “fuqinë për të bërë ndryshime” gratë.

## 5.2. Dominimi i politikës nga burrat

Në mesin e 61 përqind të anketuarve në anketë të cilët shfaqën opinionin se gratë ndjekin një rrugë më të vështirë drejt posteve të larta politike, tre arsyt kryesore të përmendura ishin: obligimet familjare të grave dhe puna, mbështetja e pamjaftueshme nga burrat në lidhshkrimin partiak si dhe rregullat, praktikat dhe konkurrenca e brendshme partiake. Ky rezultat është i vazhdueshëm me renditjen e të anketuarve të barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe në proceset zgjedhore.

Fokus grupi i grave kandidate ishte unanim në vlerësimin e tyre se numri aktual i grave politike është shumë larg nivelit të kënaqshëm. Këto pjesëmarrëse të fokus grupeve ia atribuon çdo rritje të kohëve të fundit të anëtarësimit të grave në partitë politike dhe të numrit të grave në listat e kandidatit vetëm me futjen e kuotës së përcaktuar ligjore. Gratë kandidate deklaruan se gratë rrallë herë arrijnë në poste vendimarrëse në kryesitë e partive politike ose në funksione shtetërore dhe zgjedhore si kryetare të komunave ose ministre. Sipas pjesëmarrësve të këtij studimi, një nga arsytet se pse ndodh kjo gjë, është për shkak të barrës jo proporcionale të punëve amvisërore që mbartet kryesisht nga gratë. Kjo situatë rezultoi që burrat të kenë më shumë kohë në dispozicion aktivisht të merren me politikë dhe kështu të fitojnë më tepër përvojë në këtë sferë se gratë.

Si plotësim, pjesëmarrëset në fokus grupin e kandidateve gra shprehën qëndrimin se nuk ekziston vullnet i mjaftueshëm politik në mesin e burrave në partitë politike t'i mbështesin gratë dhe t'i përcaktojnë për funksionet më të larta brenda

partive të tyre. Sipas këtyre kandidatëve, burrat e kanë të vështirë t'ua lëshojnë pushtetin grave apo të pranojnë që gratë të marrin poste mbi ta në hierarki. Më tej, pjesëmarrësit ishin të mendimit se meqenëse burrat mendojnë se i kanë dhënë pjesë të konsiderueshme të fuqisë së tyre grave, kur gratë arrijnë poste më të larta, burrat u vendosin pritshmëri dhe kërkesa më të mëdha grave për të justifikuar postet e tyre.


Perceptimi për politikën se dominohet nga burrat ishte veçanërisht mbizotërues në mesin e të anketuarve të përkatësisë etnike shqiptare. Në të vërtetë, përmbledhja tabelore e kryqëzuar në bazë të etnisë që tregon perceptimin se ka shumë më pak anëtare gra në parti është më e lartë në mesin e të anketuarve të përkatësisë etnike shqiptare (51.8% ndaj 18.6% të etnisë maqedonase dhe 27.2% të të gjithë të anketuarit). Nga të anketuarit të etnisë shqiptare, 74.1 përqind nuk kanë vërejtur ndonjë rritje të numrit të grave kandidate në zgjedhjet lokale të v. 2021, krahasuar me 49 përqind të etnisë maqedonase dhe 56.1% të të gjithë të anketuarit të cilët perceptuan një rritje të tillë. Ngjashëm një përqindje e lartë e etnisë shqiptare vërejtën se burrat dhe gratë nuk ishin njëllëj të pranishëm në debatet publike gjatë këtyre zgjedhjeve, ndërsa 52.8 përqind e etnisë maqedonase dhe 58.2 përqind e të gjithë të anketuarve treguan se të dyja gjinitë ishin njëllëj të pranishme në këto debate.

## 5.3. Dekonstruksioni i ndjeshmërisë së veçantë gjinore ndaj ekspozimit publik

Raporti i vendit i Maqedonisë së Veriut i prodhuar nga Drejtoria e përgjithshme e KE-së për fqinjësinë dhe negociatat e zgjerimit në v. 2021 përfshiu përfundimet e mëposhtme lidhur me përhapjen e keqpërdorimit onlajn ndaj grave, sidomos atyre në jetën publike:

**Stereotipet gjinore mbijetojnë, e gratë në jetën publike veçanërisht janë të ndjeshme ndaj sulmeve përmes mediave sociale. Dy rastet e ‘Dhomës publike’ ku fotot eksplicite dhe informacioni privat i vajzave dhe grave u shpërndanë në platformën onlajn, shkaktuan shqetësimin publik dhe protestat qytetare ndaj mungesës së veprimit të duhur nga organet dhe treguan mungesën e kornizës ligjore.<sup>38</sup>**

<sup>38</sup> Komisioni Evropian, Strasburg, 19.10.2021  
Dokument i punës së stafit (2021) 294 final.



Gratë kandidatë në fokus grupet vlerësuan se ato kanë qenë dukshëm më të ekspozuara ndaj gjuhës ofenduese në media dhe mediat sociale se kolegët e tyre burra. Në këndvështrimin dhe përvojën e tyre, mizogjinia, objektivizimi dhe seksualizimi i grave është jashtëzakonisht një dukuri e shpeshtë në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në mediat sociale. Ky model i portretizimit negativ dhe sulmeve të targetuara drejt grave është jo produktiv dhe e pa mundëson rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe politike.

**“Gjatë tërë fushatës, emri im u keqpërdor, veçanërisht në komentet e artijkuve mediatikë. Më thane gjëra të tmerrshme, madje shpifën në nderin tim. Mendoj se shumica e grave i frikësohen këtij reagimi, pasi ne kemi vëllezër, motra, bashkëshortë dhe fëmijë të cilët po ashtu janë pjesë e mediave sociale dhe lexojnë këto opinione të ashpra për ne. Kishte pika ku unë pyesja vetveten a ja vlente keqpërdorimi dhe a duhet të vazhdoj tutje me fushatën time.”**

Këtë perceptim e shkëmbyen pjesëmarrësit të fokus grupit mbi mediat dhe çështjet gjinore, të cilët u pajtuan se gratë më së shpeshti janë shënjestër në media dhe se karriera e tyre politike cenohet nga gjuha ofenduese dhe sulmet e tjera të drejtpërdrejta në karakterin dhe dinjitetin e tyre. Këto sulme, veçanërisht në mediat sociale dhe mediat e tjera onlajn, në masë të madhe do t'i dekurajonin gratë dhe do të zvogëlonin gatishmërinë e tyre për angazhimin publik dhe aktiv në politikë.

Ekzistojnë katër dimensione kryesore të ndjeshmërisë së kandidatëve gra ndaj ekspozimit publik:

**(I) MUNGESA E RREGULLIMIT DHE /OSE MODERIMI I PËRMBAJTJES ONLAJN QË SJELL ME VETE MUNGESË LLOGARIDHËNIEJE.** Në diskutimet e fokus grupeve, kandidatet gra të pavarura dhe të përcaktuara nga partia shprehën kënaqësinë nga pranimi pozitiv i publikut dhe medias, por jo nga trajtimi i tyre në mediat sociale.

Përderisa shtrirja e fushatave zgjedhore nga mediat tradicionale (TV-ja dhe shtypi) monitorohet me rregulla të qarta dhe të zbatueshme (të paktën për zgjedhjet parlamentare), media onlajn mbetet gjithandëj e parregulluar, përkundër num-

rit të madh të mediave. Siç përmendet në raportin e Komisionit të Venecias 2019 për Teknologjitë dixhitale dhe zgjedhjet:

**Thënë gjerësisht, janë dy forma të ndryshme të fushatës problematike zgjedhore të cilat lehtësohen në këtë kontekst; së pari, manipulimi i partive politike, kandidatët dhe fushata e tyre dhe së dyti, aktivitetet dashakeqe tok me fushatën dezinformuese, llogaritë problematike (botet që përforcojnë mesazhe të rreme, llogari të rreme që paraqiten si aktorë legjitimë, etj.) ose spiunimi kibernetik, i cili kyç aktivitete të mundshme jashtëligjore. Aq më tepër, krijimi anonim dhe shpërndarja rretheqark e përmbajtjes e vështirëson seriozisht identifikimin dhe cilësimin e përgjegjësiave për sjellje të paligjshme onlajn, ku zgjedhësit mund të preken seriozisht gjatë përcaktimit të tyre prej informacioneve të gabuara, manipulative dhe të rreme që krijohen për të ndikuar në votën e tyre, duke rrënuar ushtrimin e së drejtës për zgjedhje të lira dhe krijon rreziqe të konsiderueshme në funksionimin e sistemit demokratik.<sup>39</sup>**

Në raportin e tij përfundimtar për zgjedhjet lokale në tetor të v. 2021, Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it vuri në dukje se për shkak të “mungesës së rregulloreve të qarta të fushatës në rrjete sociale dhe moderimit efektiv të komenteve nga partitë dhe kandidatët në faqet e mediave sociale të tyre, shumë kandidatë, shpesh gra, iu nënshtruan fjalorit fyës”.


**(II) PËRJETËSIMI I STEREOTIPEVE GJINORE TË MEDIAS TRADICIONALE.** Ngulitja e nocioneve patriarkale në shoqëri shihet qartë në portretizimin mediatik të grave kandidatë që përjetësojnë stereotipet gjinore. (Ky aspekt i ndjeshmërisë së grave ndaj ekspozimit publik analizohet thellësisht në kapitullin si në vijim.)

**(III) MUNGESA E SHKATHËTËSIVE DHE PËRGATITJA PËR PARAQITJET MEDIATIKE.** Gratë kandidatë në fokus grupet përmendën stresin që lind nga ekspozimi i tyre publik dhe paraqitjet publike në media si një pengesë tjetër kyçe. Disa pjesëmarrës përmendën veçanërisht vetëbesimin e ulët dhe nivelet e larta të vetë kritikës për shkarjet e gjuhës gjatë fjali- meve publike. Në këtë drejtim, shumë prej tyre iu

<sup>39</sup> Raporti i përbashkët i Komisionit të Venecias dhe të Drejtorisë së Shoqërisë së Informacionit dhe aksioni ndaj krimit i Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit (DGI) për Përdorimin e teknologjisë dixhitale dhe zgjedhjet, CDL-AD(2019)016, paragrafi 37. Në dispozicion në [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2019\)016-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2019)016-e)



referuan mungesës së trajnimit që kishin marrë për paraqitjet publike dhe marrëdhëniet me mediat, me ç’gjë vetëm tre pjesëmarrës kanë ndjekur trajnim të tillë nga partitë e tyre politike ose nga organizatat ndërkombëtare. Kur u pyetën se çka do të bënin ndryshe në zgjedhjet e ardhme në të mirë të përvojës që kanë fituar nga zgjedhjet e tetorit 2021, përgjigjet më të zakonshme ishin se ato do të jenë më pak vetëkritike dhe më vetëbesim, “të guximshme” dhe ambicioze, duke deklaruar se kjo do t’ju mundësojë atyre të shprehin kërkesat dhe opinionet e tyre më fuqishëm, qartësisht dhe konkretisht.



*Pjesëmarrësi tjetër në fokus grupin theksoi si më poshtë:*

“Njerëzit gjithmonë do t’ju sulmojnë duke qenë se jeni gra. Madje edhe në rrugë do t’ju trajtojnë si më pak të vlefshme. Në mediat sociale, për shkak të shtrirjes dhe anonimitetit, këto sulme përforcohen dhe çojnë në probleme të mëdha. Në anën tjetër, nuk ka reagim institucional për të parandaluar këtë keqpërdorim, dhe njerëzit nuk kanë edukim adekuat. Kam vështruar shumë kërcënime me jetë dhe komente negative, më së shumti që prekin moralin tim, por edhe gjëra për familjen time. Nuk i kushtoj rëndësi asaj që thonë njerëzit e tillë kur e di se synimet e mia janë të pastra, por mendoj se burrat nuk përballen me gjuhën e njëjtë ofenduese si gratë.”

**(IV) DËSHTIMI I PARTIVE POLITIKE PËR T’I FUQIZUAR DHE MBROJTUR GRATË KANDIDATE.** Asnjëra nga dhjetë partitë politike të vlerësuara në studimin e USAID-it të shtatorit 2020 mbi “Dhunën ndaj grave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut”<sup>40</sup> nuk kishin kodin formal të sjelljes që rregullon sjelljen e anëtarëve partiakë ose mbron gratë politikane dhe aktivistët nga dhuna. Ky raport përfshiu vlerësimin e mëposhtëm:

Përfaqësuesit e LSDM-së, DOM-it, dhe LDP-së treguan se partitë e tyre planifikojnë të përgatisin dhe inkorporojnë kodin e sjelljes duke i përfshirë dispozitat që të parandalohet çfarëdo lloji i dhunës. Funkionarët e LSDM-së obli-

gohen ta nënshkruajnë Deklaratën e nderit para se të marrin ndonjë post, duke u zotuar se nuk do të përdorin fyerje, shpifje, dhunë dhe kërcënime, gjuhë ofenduese, apo të japin informata të rreme a premtime. Alternativa është partia e vetme politike e cila e ka Kodin e etikës që ndalon konkretisht zyrtarin e partisë të kryejë çfarëdo lloj keqpërdorimi seksual a çfarëdo lloj akti që ka të bëjë me një keqpërdorim të tillë a shqetësim.

Nga pikëpamja e të anketuarve, “ndryshimi i mentalitetit” është mënyra më e rëndësishme për një angazhim më të madh të grave në politikë dhe përfaqësim më të lartë të grave në politikat lokale. Si plotësim, gratë që kandidojnë duhet të përgatiten më mirë për t’i bërë ballë ekspozimit publik dhe të marrin trajnime profesionale në komunikimet onlajn.

40 Shih shënimin 20.

# 6. Ngritja e pjesëmarrjes përmes qasjes së baraspeshuar dhe portretizimit të ndershëm të kandidatëve: Roli i medias në kundërvënien e stereotipeve gjinore

**D**uke marrë parasysh nevojën e kandidatëve të cilët aspirojnë në zgjedhje që të bëjnë fushatë aktive për t'u vërejtur prania dhe idetë e tyre gjithandej, dhe meqë prania mediatike është mjeti më i mirë për të tërhequr audiencë, duhet të kuptohet më mirë roli specifik i medias në përjetësimin ose kundërvënien e stereotipeve gjinore që kanë ndikim negativ në pjesëmarrjen e grave në politikë.

## 6.1. Shtrirja e fushatës zgjedhore 2021 në media përmes thjerrëzave gjinore

Kodi zgjedhor i Maqedonisë së Veriut parashikon rregullore të detajuara të sjelljes së mediave nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e fushatës politike. Andaj, të gjithë transmetuesve dhe ueb faqeve u kërkohet t'i raportojnë zgjedhjet në mënyrë të ndershme, të baraspeshuar dhe të paanshme<sup>41</sup>.

Janë ndërmarrë disa veprime në kuadër të ligjit për Shërbime mediatike audio dhe audio- vizuale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ndryshuar me ligjin (248/2018), që të trajtohet portretizimi i grave dhe vajzave dhe të parandalohen diskriminimet e paragjykimet gjinore në media. Ky ligj ka për synim të integrojë perspektivën gjinore në politikëbërje.

Që nga v. 2012, rregullatori i medias në Maqedoninë e Veriut, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ASHMAA), ka ndërmarrë

rë disa iniciativa që të dokumentojë, të trajtojë, dhe të ndërgjegjësojë për çështjet lidhur me përfaqësimin e grave dhe burrave në konceptet dhe përmbajtjet programore të mediave.<sup>42</sup> Në bazë të nenit 17 të ligjit për Mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, përfshihen aktivitete për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave në lidhje me gjininë në media dhe ofrimin të trajnimeve për profesionistët e medias që të inkurajohet zhvillimi dhe përdorimi i imazheve të ndryshme, jostereotipike, të baraspeshuara të grave dhe të vajzave në media.

Konstatimet e analizës së ASHMAA-së<sup>43</sup> të shtrirjes mediatike të fushatës zgjedhore parlamentare të v. 2020 zbuluan se mediat ishin jashtëzakonisht të prirura për t'i promovuar burrat që kandiduan për deputetë dhe perspektivat e tyre si dhe ekspertizën e zhvillimeve lidhur me zgjedhjet. Në këtë mënyrë, kandidatet gra ranë nën hijen e kolegëve të tyre burra të shtrirjes mediatike, me qasje më të vogël të formave të ndryshme të promovimit të platformave të tyre. Si pasojë e kësaj, profilet dhe mesazhet e kandidatëve gra mbetën kryesisht të padukshme dhe të padëgjues nga publiku.

42 Raporti i qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim (1995) dhe rezultatet e Sesionit të dytë special të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (2000) – Pekin +25. 2019.

43 ASHMAA ngarkoi Institutin për Demokraci Societas Civilis në Shkup për të kryer një analizë të çështjeve gjinore dhe mënyrën e përshkrimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në lajme të transmetuara në televizionet kombëtare gjatë fushatës zgjedhore.

41 Nenet 75 dhe 76 të Kodit zgjedhor.

Ekstrakte nga ligji për Shërbime mediatike audio dhe audio-vizuele

**Neni 48 (paragrafi 1)** përfshin seksin, orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të ndaluara diskriminimi në programet radiotelevizive.

**Neni 53 (paragrafi 4, alineja 2)** ndalon diskriminimin në bazë të seksit dhe orientimit seksual në reklama.

**Neni 61 (paragrafi 1, alineja 2)** kërkon që të gjithë transmetuesit të respektojnë barazinë e lirive dhe të drejtave pavarësisht nga seksi i personit (ndër të tjera).

**Neni 110 (paragrafi 1, alineja 6)** përshkruan që Transmetuesit e Shërbimit Publik të prodhojnë programe që respektojnë dhe promovojnë barazinë ndërmjet sekseve.

**Neni 116 (paragrafi 4)** parasheh që anëtarësia e Këshillit programor të Radio dhe Televizionit të Maqedonisë duhet të pasqyrojë diversitetin e shoqërisë në Maqedoni me përfaqësimin adekuat të të dy sekseve biologjike.

Në raportet e mediave për fushatën e zgjedhjeve parlamentare të v. 2020, 128 nga 134 përfaqësuesit e partive politike të përmendur ose të intervistuar nga gazetarët ishin burra, në krahasim me vetëm gjashtë gra. Në programet e lajmeve ditore dedikuar temave të zgjedhjeve, 86 përqind të atyre që u shfaqën si subjekte kryesore të këtyre programeve ishin burra dhe vetëm 14 përqind ishin gra. Analiza cilësore e përmbajtjes së programeve të këtilla të lajmeve ditore tregoi se gratë u objektivizuan seksualisht gjithsej në nëntë lajme, ndërsa gjashtë raporte përjetësuan stereotipet për gratë të cilat ende mbizotërojnë në shoqëri.<sup>44</sup> Nuk kishte në dispozicion asnjë analizë gjinore të fushatave politike të zgjedhjeve lokale 2017 dhe 2021.

Gjatë fushatave zgjedhore të v. 2021, sfidat e zbatimit të buxhetit të përgjegjshëm gjinor në nivel lokal, mund të kishin ofruar një bazë të fuqishme të gjenerimit të diskutimeve të frytshme mbi gjininë dhe pushtetin lokal. Siç është vënë në dukje në raportin e Misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, megjithatë, "gratë nuk ishin aq të përfaqësuara në fushatat e partive, ndërsa temat lidhur me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave mungonin kryesisht në fjalimet dhe platformat e garuesve, pavarësisht përpjekjeve të kufizuara të disa partive për të prezantuar politika të tilla para votuesve".

<sup>44</sup> Analiza e gjinisë gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020. Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq –Instituti për Demokraci Societas Civilis.

## 6.2. Qasje e padrejtë dhe portretizime të pabarabarta në media të grave kandidatë gjatë zgjedhjeve lokale 2021

Vetëm një e treta e qytetarëve të anketuar për studimin aktual ishin të mendimit se gratë dhe burrat janë njëllor të pranishëm në debatet publike, ndërsa qytetarët e etnisë shqiptare dhe të anketuarit në rajonet rurale ishin me gjasa më të pakta për ta ndarë këtë mendim. Dallimi i vogël në perceptimet ishte i dukshëm kur të anketuarit u pyeten konkretisht nëse të dyja gjinitë ishin të pranishme në mënyrë të barabartë në debatet publike gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, megjithëse gjashtë nga 10 të anketuar mbetën të mendimit se këto debate nuk kanë qenë të baraspeshuara në aspektin gjinor.


Të dhënat e anketës nga ky studim zbulojnë mëtej një nivel dukshëm më të lartë të mospranimit, ndërmjet meshkujve sesa femrave të anketuar, se për gratë janë pritshmëritë më të larta kur ato janë figura publike. Përsëri, një diferencë prej 20 përqind ndërmjet meshkujve dhe femrave të anketuar është e evidente lidhur me këtë çështje, që tregon diferencën e përafërt në këtë drejtim ndërmjet të anketuarve vetëm me arsim fillor kundrejt atyre të diplomuar me arsim të lartë. Ndërsa 67.7 përqind e femrave të anketuara u pajtuan se gratë në jetën publike përballen me pritshmëri më të larta, 52.6 përqind të meshkujve të anketuar ose nuk u pajtuan, nuk e dinin, ose refuzuan të përgjigjen.

Të dhënat e hulumtimit vërtetojnë më tej anshmëritë gjinore në portretizimin e grave kandidatë në media. Mediat u përqendruan më tepër në pamjen dhe jetën private të grave kandidatë.

Këtë anshmëri më tej e vërejtën edhe pjesëmarrësit në fokus grupin e gazetarëve, përfaqësuesve të medias dhe përfaqësuesve të Këshillit të etikës në media. Këta pjesëmarrës jo vetëm që e vërtetuan mungesën e barazisë dhe drejtësisë, në mënyrën se si burrat dhe gratë janë portretizuar si kandidatë politikë, por gjithashtu vërejtën se gratë shpesh herë objektivizohen dhe seksualizohen në portretizimet mediatike. Disa nga pjesëmarrësit e fokus grupeve iu referuan analizave të mëparshme të ndërmarrë nga organizatat e tyre që ta mbështesin vlerësimin e tyre se gratë në media shpesh portretizohen si viktima dhe si individë pa fuqi vendimmarrëse, veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19.

**Figura 9**

Fokusi i mediave në aspekte të ndryshme të kandidatëve gra dhe burra



Përzgjedhja e kandidatëve për debatet dhe emisionet televizive në mediat private mbetet kryesisht çështje e gjyqimit të redaksisë. Gazetarët në fokus grupet të organizuara për këtë studim i theksuan vështirësitë e përfshira në motivimin e grave që të marrin pjesë nëpër debatet publike televizive. Sipas këtyre praktikuesve të medias, tre arsye më të shpeshta të rezistencës së grave për të marrë pjesë në debatet publike ishin si në vijim: (i) turpi, ndjenja e parehatshme para kamerave; (ii) frika nga gjuha ofenduese ndërlidhur me pamjen fizike të tyre, në vend të ekspertizës së tyre dhe atë që në fakt ato e thonë, veçanërisht në mediat sociale; dhe (iii) mbështetje e pamjaftueshme nga partitë politike që ato përfaqësojnë. Pabarazitë në pjesëmarrjen e grave në debatet publike dhe ftesës së tyre në debate të tilla është pasojë e drejtpërdrejtë e portretizimit të njëanshëm gjinor të grave politike.

### 6.3. Mbështetja e pjesëmarrjes së grave: zhvendosja nga përjetësimi i stereotipeve gjinore në promovimin aktiv të barazisë gjinore

Në diskutimet e fokus grupeve të mbajtura me praktikuesit e mediave, pjesëmarrësit sugjeruan një numër mënyrash duke ndihmuar të kapërcehen barrierat e pjesëmarrjes dhe paraqitjes së grave në media. Këto ishin dy propozimet krye-

sore: i) të autorizohen dhe/ose të krijohen njësi të burimeve njerëzore në çdo media që të miratohen rregullore dhe procedura të përcaktuara qartë për garantimin e barazisë gjinore të stafit; dhe ii) futjen e perspektivës së barazisë gjinore në rrjedhat kryesore të politikës redaktuese të të gjitha mediave. Nevoja për rregullore të tilla është evidente nga fakti se, megjithëse, gazetarët dhe përfaqësuesit e medias u përpoqën të ofronin vlerësime pozitive të nivelit të ndjeshmërisë gjinore në mediat e tyre përkatëse, në bazë të respektimit të rregullave dhe udhëzimeve të tyre të brendshme, ata gjithashtu bënë të ditur se shumica e çështjeve gjinore në raport me median iu lanë gjyqimit të gazetarëve dhe mekanizmit vetë rregullues të medias pa ndonjë kontroll të mëparshëm ose strategji koherente. Këto çështje të gjyqimit kanë të bëjnë me përfshirjen e folëseve dhe grave eksperte dhe të portretizimit të tyre, si dhe me çdo iniciativë që ka për synim të promovojë gratë udhëheqëse ose ekspozimin e stereotipeve gjinore në media.

Prandaj, politika redaktuese gjinore, e zbatuar nga këshillat redaktues të baraspeshës gjinore, do të mund të lehtësonte kyçjen në rrjedhat kryesore të perspektivës së ngritjes së ndërgjegjësimit gjinor, duke përfshirë njohjen e fjalorit diskriminues gjinor dhe nevojën për raportim të baraspeshuar gjinor për të rritur ndjeshmërinë ndërmjet praktikuesve të medias. Siç sugjeruan gazetarët dhe përfaqësuesit e medias të cilët



morën pjesë në fokus grupe, redaksia mund të prezantojë praktikën e vetanalizës dhe reflektimit në portretizimin e grave dhe çështjeve gjinore në media si një “bisedë” të vazhdueshme me gazetarët. Për një informim dhe përmirësim të diskutimeve të tilla të vazhdueshme, gazetarët dhe redaktorët mëtej duhet të nxiten të marrin trajnimin e duhur, me qëllim që t’i zhvillojnë shkathtësitë e tyre për ndjeshmërinë gjinore. Trajnimet e tilla mund të kenë ndikim pozitiv, duke mundësuar prodhime mediatike efektive të cilat zbulojnë stereotipet, paragjykimet, diskriminimin dhe gjuhën ofenduese ndaj grave në përgjithësi dhe ndaj grave në politikë në veçanti, si dhe në prodhimet mediatike të cilat promovojnë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në proceset zgjedhore dhe politike. Ato do të formonin kornizën e cila do t’u mundësonte mediave që të fillojnë trajtimin e shtrirjes së njëanshmërisë gjinore dhe të portretizimit të grave kandidate të identifikuara në këtë hulumtim dhe në tjerat.

Praktikuesit e medias në fokus grup rekomanduan gjithashtu zbatimin e kontrolleve më të rrepta të funksionimit të mediave onlajn dhe të retorikës së mediave sociale. Si plotësim, ata theksuan nevojën për ndërtimin e kapaciteteve për kandidatet gra që t’i ndihmojnë grave të zhvillojnë aftësitë e të folurit publik dhe të forcojnë vetëbesimin e tyre. Sipas këtyre pjesëmarrësve, një ndërtim i tillë i kapaciteteve duhet të ndërmerret nga partitë politike, meqë partitë e

kanë për detyrë t’ua ofrojnë tërë mbështetjen e nevojshme grave kandidate për t’i fuqizuar që të marrin pjesë në media dhe në politikë në baza të barabarta me kandidatët burra.

# 7. Konstatimet kryesore, përfundime dhe rekomandime

**K**y studim nxjerr në pah se gratë vazhdojnë të mbeten jo aq të përfaqësuara në politikën e vendit, pavarësisht përpjekjeve të shumta për të zvogëluar divergjencën gjinore, dhe se gratë vazhdojnë të përballen me sfida të konsiderueshme në ushtrimin e ndonjë ndikimi thelbësor politik.

---

**41 e meshkujve të anketuar dhe 61.1 e femrave të anketuara e perceptojnë kandidimin e grave për funksione si një zhvillim të domosdoshëm dhe pozitiv.**

---

Përderisa rezultatet e anketës tregojnë se interesi i përgjithshëm në politikën aktuale është relativisht i ulët, veçanërisht në mesin e gjeneratës së re, niveli i interesit të veçantë për gratë dhe pjesëmarrjes së tyre politike në zgjedhjet lokale dhe parlamentare ndërmjet të anketuarve ishte shumë më i lartë, për shkak të opinionit të theksuar të grave të anketuara. Megjithatë, dëshmitë e qarta të mbështetjes së grave për pjesëmarrjen e grave në politikat lokale të identifikuara në këtë studim nuk u përkthyen në votë parapëlqyese për gratë në zgjedhje. Në përgjithësi, rezultatet e anketës tregojnë se, megjithëse, shumica e publikut ka një perceptim të baraspeshuar dhe mjaft të saktë për mungesën e qasjes së grave në postet udhëheqëse, ka gjithashtu dëshmi të qarta të rezistencës së burrave ndaj imponimit të formulave të kuotave gjinore.

---

**56.6 e meshkujve të anketuar dhe 78.9 përqind e femrave të anketuara shprehën mbështetje për rritjen e hapësirës së grave në politikë në nivel lokal.**

---

Ekziston një dallim i dukshëm prej 22.3 pikësh përqindjeje që mund të shpjegohet me faktin se një e treta e meshkujve të anketuar shfaqën pikëpamjet që pasqyrojnë stereotipet tradicionale të karakteristikave gjinore dhe roleve. Është interesant qëndrimi se “ndryshimi i mentalitetit” është ajo që nevojitet më së shumti për të arritur një cilësi më të lartë të pjesëmarrjes së grave në politikën lokale që ndahej pothuajse në mënyrë të barabartë nga të anketuarit meshkuj dhe femra. Ndikimi i stereotipeve gjinore në zgjedhjen e të anketuarve për kandidatët gra apo burra pasqyron portretizimin e padrejtë të grave politike në media, veçanërisht në përqendrimin mediatik të statusit martesor dhe pamjen fizike të grave kandidate, në vend të pikëpamjeve dhe propozimeve të tyre lidhur me çështjet politike.

## 7.1. Reformat zgjedhore dhe korniza ligjore

---

**67% e të gjithë të anketuarve mbështesin rritjen e hapësirës për gratë në politikat lokale**

---

Ky studim konstaton dëshmi në nivelin e mbështetjes dhe kërkesës së përfaqësimit të



grave në politikë që nuk kënaqej nga partitë politike dhe i kalon konsiderueshëm nivelet aktuale të përfaqësimit. Ky konstatim duhet të shërbejë si një shtytës që të zhvillojë modelin më gjithëpërfshirës të garës zgjedhore në zgjedhjet e shumicës së njësive zgjedhore me një mandat, duke treguar se partitë politike kanë parasysh se votuesit mbështesin zmadhimin e hapësirës së grave në politikën lokale.

***“Aty ku sistemet zgjedhore tregohet se kanë një ndikim negativ në përfaqësimin politik të grave në organet e zgjedhura, rregulloni ose reformoni këto sisteme për të promovuar përfaqësimin e baraspeshuar gjinor”***

Shtojca e rekomandimit Rec(2003)3 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare në pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave në vendimarrjen politike e publike.

**Duke marrë parasysh nivelin e ulët të grave të zgjedhura për kryetare të komunave, nevojitet të iniciohet një diskutim mbi mënyrat e përmirësimit të përfshirjes së sistemit zgjedhor.**

Duke e njohur reformën zgjedhore si gjinore, rrjedh se të gjitha diskutimet dhe opsionet për një reformë të tillë duhet të vlerësohen sipas ndikimit të tyre në përfaqësimin gjinor. Konsideratat e tilla duhet të zbatohen, si për shembull, në çdo diskutim rreth propozimeve për të ecur përpara drejt një sistemi me listë të hapur për zgjedhjen e deputetëve dhe të këshilltarëve. Në rastin e listave të mbyllura, siç zbatohet aktualisht në zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut janë partitë politike ato që e përcaktojnë renditjen e kandidatëve në fletëvotim, përderisa zgjedhësi e mbështet të gjithë listën pa asnjëfarë mundësie të ndryshimit të radhitjes në të cilën u ndahen mandatet kan-

***“Komiteti i Ministrave rekomandon që shtetet anëtare të KE-së duhet të konsiderojnë miratimin e reformave legjislativë që të vendosin pragjet e barazisë për kandidatët në zgjedhje në të gjitha nivelet. Aty ku zbatohen listat proporcionale, duhet të merret parasysh futja e “sistemeve zinxhir”, duke alternuar të dy sekse. (Rec(2003)3, Shtojca A, 3).”***

didatëve. Me lista të hapura ose të lira, ndodh e kundërta, zgjedhësit mund të ndryshojnë rendin e radhitjes së kandidatëve në lista. Aty ku votimi parapëlqyes ose votimi i kryqëzuar është i mundshëm, megjithatë, zgjedhësit nuk do të zgjedhin domosdoshmërisht kandidatë nga të dy sekse: listat e hapura mund të funksionojnë në dobi të kandidatëve të mirënjohur burra.

Ndikimi i listave të hapura në përfaqësimin gjinor ndryshon në bazë të përvojës kombëtare dhe kontekstit. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, një studim i v. 2017 arriti përfundimin e mëposhtëm:

Hapja e rregullave zgjedhore ndikon në mbështetjen e kandidateve femra në përgjithësi. Të dhënat japin dëshmi të qartë se sistemet e hapura zgjedhore lidhen me më shumë vota për gratë dhe se sistemi i përzier sjell shumicën e votave për gratë.<sup>45</sup>

Në zgjedhjet e mbajtura në Bosnje dhe Hercegovinë që nga futja e kuotave gjinore dhe listave të hapura në v. 2002, është shënuar një ulje dramatike të numrit të grave të zgjedhura krahasuar me zgjedhjet e v. 1998 kur kuotat u aplikuan së bashku me listat e mbyllura. Hulumtimi i Parlamentit Evropian dhe të Komisionit të Venecias theksuan ndikimet negative të mundshme të listave të hapura të përfaqësimit gjinor, por vlerësuan ndryshe kapacitetin e votës parapëlqyese për të kundër baraspeshuar këto ndikime. Sipas raportit të Parlamentit Evropian për “ndikimin diferencial të sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik të grave”:

<sup>45</sup> Golder, S., Stephenson, L., Van der Straeten, K., Blais, A., Bol, D., Harfst, P., dhe Laslier, J. (2017). Votat për gratë: Sistemet zgjedhore dhe mbështetja për kandidatet gra. *Politika dhe gjinia*, 13(1), 107–131.

Përderisa duhen marrë parasysh faktorë të tjerë, siç është konteksti socio-politik i çdo vendi, mund të thuhet se sistemet parapëlqyese, ku trupit votues u lejohet të zgjedhë, janë pengesa të mundshme të përfaqësimit politik të grave. Megjithatë, kjo nënkupton gjithashtu se vetë partitë politike kanë një rol jetik në lidhje me vendosjen e kandidateve femra në poste të pranueshme; ky është veçanërisht rasti me sistemet zgjedhore të listave të mbyllura.<sup>46</sup>

Sipas raportit të Komisionit të Venecias për “ndikimin e sistemeve zgjedhore të përfaqësimit të grave në politikë:

Listat e hapura mund të funksionojnë në të mirë të kandidatëve meshkuj të cilët i njohim. Prandaj, ekziston një rrezik i natyrshëm që futja e listave të hapura mund të rezultojë në zgjedhjen e më pak grave ...

Megjithatë, listat e hapura nuk duhet të pengojnë përfaqësimin e grave. Deri në shkallën në të cilën gratë organizohen dhe bëjnë fushatë aktive për votimin e kandidateve femra, votimi parapëlqyes mund të mos ndikojë ndaj grave, por mund të rezultojë në përfaqësim më të fuqishëm të grave.<sup>47</sup>

Edhe pse hulumtimi i kryer për studimin aktual vërteton se ka ende një 36 përqindësh solid të grave në Maqedoninë e Veriut të cilat ose nuk janë edhe aq shumë, ose nuk janë të interesuara aspak për pjesëmarrjen e grave në politikë, analiza e rezultateve të anketës zbulon se niveli shumë i lartë i mbështetjes mes grave për futjen e perspektivës gjinore në procese politike dhe zgjedhore nuk përkthehet në një votë automatike parapëlqyese të grave për kandidatet gra. Për këtë arsye, duket se mënyra më e mirë që **të konsolidohet numri i grave në postet e zgjedhura është të futet “sistemi zinxhir”** i rekomanduar nga Këshilli i Evropës.<sup>48</sup> Më tej **në Kodin zgjedhor mund të futen edhe dispozitat për të siguruar përfaqësimin e baraspeshuar.**

46 Parlamenti Evropian, “Ndikimi diferencial i sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik të femrave”, Drejtoria e Përgjithshme për Hulumtime, Dokumenti i punës SERIALI I TË DREJTAVE TË GRAVE - W-10. Në dispozicion [https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/femm/w10/1\\_en.htm](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/femm/w10/1_en.htm)

47 Raport i Komisionit të Venecias për “ndikimin e sistemeve zgjedhore të përfaqësimit të grave në politikë, CDL-AD(2009)029, 2009, në [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2009\)029-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2009)029-e)

48 Rekomandimi Rec (2003)3 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave në marrjen e vendimeve politike dhe publike

Hulumtimi i mëparshëm gjeti dëshmi të shumta se mungesa e rregullimit të komunikimeve politike dhe të llogaridhënies për gjuhën ofenduese dhe/ose gjuhën diskriminuese në mediat sociale, veçanërisht gjatë fushatave politike, përkthehet drejtpërdrejt në një ndjeshmëri më të madhe për gratë kandidate ndaj ekspozimit negativ publik. Në raportin e përbashkët,<sup>49</sup> Komisioni i Venecias vërejtj se:

Nëse nga njëra anë përdorimi i teknologjive dixhitale mund t’i bëjë proceset demokratike më të qasshme për të gjithë qytetarët, mund të sjellë gjithashtu edhe pengesa gjatë realizimit dhe zhvillimit të demokracisë zgjedhore, duke sjellë me vete forma të reja të ndërhyrjeve jo të duhura në të drejtën zgjedhore dhe në të drejtën e kandidimit ... të drejtën e lirisë së shprehjes ... dhe të drejtën e respektimit të jetës private.

Filtrimi, bllokimi dhe heqja e përmbajtjes së paligjshme në internet me qëllim që të luftohen veçanërisht krimet e urrejtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe të mbrohet pronësia intelektuale dhe privatësia ose të drejtat nga shpifjet që janë një realizim i domosdoshëm, por i ndjeshëm që mund të keqpërdoret dhe të përfundojë në censurë dhe në heshtjen jolegjitime të kundërshtarëve politikë. Çdo masë e tillë duhet të pajtohet me ligj ... Kriteret e domosdoshme të një shoqërie demokratike dhe të proporcionalitetit gjithmonë duhet të respektohen dhe revizioni gjyqësor efektiv nga gjykatat e pavarura dhe të paanshme duhet të garantohet.

**Në bazë të këtyre konstatimeve të hulumtimit, Maqedonia e Veriut duhet t’i shqyrtojë mënyrat për të përmirësuar rregullimin e aktiviteteve politike onlajn, dhe sanksionimin e shpifjeve dhe të gjuhës ofenduese gjatë fushatave zgjedhore.**

## 7.2. Partitë politike

Përderisa partitë politike tentojnë të ndërmarrin angazhime politike “të buta” për sjellje të mirë

49 Raport i përbashkët i Komisionit të Venecias dhe i Drejtorisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit ndaj Krimit të Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit (DGI), mbi Teknologjitë dixhitale dhe zgjedhjet, miratuar nga Këshilli i Zgjedhjeve Demokratike në mbledhjen e tij të 65-të (Venecia, 20 qershor 2019) dhe nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 119-të plenare (Venecia, 21-22 qershor 2019). Në dispozicion në [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2019\)016-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2019)016-e)



përmes nënshkrimit të kodeve të sjelljes në prag të fushatave politike, këta aktorë shpesh mungojnë/heshtin kur vjen koha për të vënë në veprim fjalët e partisë (nga kodi i sjelljes) duke rregulluar praninë e tyre dixhitale përmes moderimit të komenteve të kanaleve të komunikimit dixhital të partisë dhe të kandidatëve partiakë në rrjetet sociale. **Partitë politike në Maqedoninë e Veriut që nuk kanë miratuar ende kode formale të sjelljes që rregullojnë sjelljen e anëtarëve të tyre duhet urgjentisht të miratojnë kode të tilla, duke përfshirë detajet e procedurave të zbatueshme dhe sanksione për mosrespektimin e kodit të partisë.**

### **61 përqind e të anketuarve mendojnë se gratë më vështirë arrijnë në poste të larta politike.**

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuarat për studimin aktual tregojnë se shumica e qytetarëve ndajnë mendimin se gratë politike nuk kanë mbështetje të mjaftueshme nga partitë e tyre politike. Meqë duhen bërë përpjekje domethënëse që të arrihet barazia e mirëfilltë gjinore në partitë politike, rekomandohet që përpjekjet e bëra për mbrojtjen e përmirësimit të pozitës së përfaqësimit të grave në strukturat vendimmarrëse partiake duhet të kalojnë në një strategji që përqendrohet te burrat në postet udhëheqëse që të arrihet krijimi i mundësive të barabarta në partitë politike.

Përmbledhja e kryqëzuar e të dhënave të anketës në bazë të seksit biologjik tregon një pabarazi të qartë midis mbështetjes publike dhe rritjes së hapësirës politike për gratë politike dhe të perceptimeve pozitive të kandidatëve gra. Kur iu parashtrua pyetja cilët faktorë parandaluan gratë e kualifikuara që të përparonin në postet udhëheqëse brenda organizatave dhe partive politike, të anketuarit përmendën “mbështetjen e pamjaftueshme në udhëheqësi nga burrat” dhe rregullat e brendshme partiak, praktikat dhe konkurrenca si faktor i dytë kryesor pas “barrës së dyfishtë të obligimeve familjare dhe punës”. Më tej të dhënat sigurojnë dëshmi plotësuese të anësisë në bazë gjinore në perceptimet e nivelit të pritshmërisë i vendosur te gratë kur ato bëhen figura publike. Megjithatë, gjinia nuk ishte domethënëse në vlerësimet e të anketuarve për faktorët që ua bëjnë të vështirë grave të arrijnë në postet e larta politike.

Partitë politike në Maqedoninë e Veriut duhet t'i rikonsiderojnë dhe rishikojnë ofertat e tyre politike për sa i përket kandidatëve në dritën e

dëshmime të siguruara nga ky studim lidhur me shtrirjen e gjerë të vlerësimeve negative të përkushtimit të tyre për barazi gjinore. Në ndërmarrjen e një shqyrtimi të këtillë, partitë duhet të kenë parasysh edhe të dhënat e anketës që tregojnë se 67 përqind e qytetarëve janë për rritjen e hapësirës politike të grave. Nevoja që partitë të ndryshojnë nënvizohet më tej nga dëshmitë që siguron ky studim se interesi për politikën është dukshëm më i ulët te votuesit nën moshën tridhjetë vjeçare.

Përkundër dëshirës së përfshirjes së kuotës gjinore në strukturat e partisë, ky propozim ka gjasë të përballlet me shumë kundërshti dhe gratë në politikë do të duhet t'i bindin jo vetëm trupin e tyre votues, por edhe bashkëpartiakët e tyre meshkuj dhe udhëheqësinë e partisë. Duke pasur parasysh përvojat e kaluara të një rezistence të tillë, si dhe këmbënguljen dhe mbizotërimin e stereotipeve gjinore të kombinuara me perceptimet negative të kuotave gjinore zgjedhore ndërmjet publikut, partitë politike do të kenë nevojë për mbështetje që të rritin kapacitetin e tyre për monitorimin e baraspeshës gjinore, të kryejnë revizionet gjinore dhe të përdorin mjetet e kyçjes së perseptivës gjinore në rrjedhat kryesore. Përpjekjet e tilla arsyetohen duke pasur parasysh faktin se përfshirja e grave në postet udhëheqëse brenda strukturave partiake përkthehet në më shumë përcaktime dhe mbështetje më të madhe partiake për kandidatet gra.

**Partitë politike duhet të kenë struktura më të hapura të lidhshpimit të tyre për gratë dhe duhet të konsiderojnë ripërqendrimin e manifestit të tyre në çështjet gjinore.**

Të dhënat sasiore dhe cilësore të mbledhura për këtë studim nga të anketuarit dhe nga pjesëmarrësit të fokus grupeve vërtetojnë një shtrirje të gjerë të perceptimeve të vërtetuara nga përvojat personale e shumë kandidatëve gra, se mungesa e mbështetjes partiake mund t'i lërë kandidatet gra jo të përgatitura sa duhet për sukses në fushatat e tyre. Duhet të përpiqen si gratë ashtu edhe burrat politikanë edhe partitë politike për të siguruar që gratë të fitojnë, ruajnë dhe zgjerojnë kapitalin politik, duke përfshirë aftësitë e veçanta në të folurit publik dhe teknikat për komunikim dixhital efektiv.

**Partitë politike në Maqedoninë e Veriut duhet të ofrojnë të gjithë mbështetjen dhe inkurajimin e nevojshëm për kandidatet gra që të flasin në debatet publike, duke përfshirë trajnimin e kandidatëve gra dhe përfaqësuesit e zgjedhur në**

përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

### 7.3. Administrata zgjedhore

Ky studim konstaton se Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, si organ që është përgjegjës për realizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve, duhet të rritë përcaktimin e tij institucional për kyçjen e perspektivave gjinore në rrjedhat e të gjitha aktiviteteve të veta. Ky përfundim bazohet në mospërputhjen me dispozitat e barazisë gjinore në procesin e përcaktimit të komisionarëve të KSHZ-së dhe pamjaftueshmërisë së të dhënave të zbërthyer në bazë të seksit biologjik lidhur me pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe zgjedhore. Analiza mëtej sugjeron se sfidat e lartpërmendura burojnë nga mungesa e vizionit për qeverisjen e KSHZ-së nga ana e kuvendit, siç dëshmohet nga ndryshimet e shumta në përbërjen e KSHZ-së dhe kohëzgjatjes së mandatit të komisionarëve shtetërorë zgjedhorë që nga v. 2015.

**KSHZ-ja duhet t'i rishqyrtojë udhëzimet për metodat dhe procedurat e paraqitjes, pranimit dhe konfirmimit të listave të kandidatëve për zgjedhjet lokale, të parandaloj anshmërinë e natyrshme gjinore që e thekson skenarin më pak të favorshëm të renditjes së kandidatëve gjatë hartimit të listave të kandidatëve.**

Ndërtimi i përkushtimit institucional për barazi gjinore nënkupton strategji dhe planifikim afatgjatë. Edhe pse KSHZ-ja e ka arritur këtë pjesërisht me hartimin e planit strategjik dhe planit të veprimit gjinor, nevojitet inkurajim i madh për të siguruar **zbatimin e plotë të aktiviteteve të para para në planin e veprimit gjinor. Këto aktivitete përfshijnë përpunimin dhe ofrimin e trajnimeve të synuara për menaxhmentin dhe stafin dhe të prodhimit të të dhënave zgjedhore të zbërthyer në bazë të seksit.**

Për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave dhe zbërthimin e këtyre të dhënave, KSHZ-ja mëtej duhet të bëjë rishikimin e formularëve zgjedhorë dhe bazave të të dhënave, duke përfshirë edhe ato që ua ka nënkontraktuar subjekteve private të jashtme. KSHZ-ja duhet të mbështetet në vendosjen e udhëzimeve dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave si dhe përmirësimin e procedurave të aplikimit të kandidatëve. KSHZ-ja duhet po ashtu të konsiderojë angazhimin në strategjitë dhe partneritetet për të përmirësuar përhapjen e dhënave zgjedhore të zbërthyer në bazë të seksit përtej publikimit të rëndomtë të të dhënave të tilla në faqen e saj të internetit.

### 7.4. Mediat

Në përgjithësi, siç tregon studimi, gratë janë të përfshira në një betejë të vazhdueshme dhe të pabarabartë për mundësi të barabarta dhe pjesëmarrje të shtuar në proceset politike dhe zgjedhore. Pozita e tyre përkeqësohet edhe më tej prej përforcimit të stereotipeve gjinore dhe të portretizimeve shpesh nënçmuese në mediat tradicionale dhe onlajn, që rrënon drejtpërdrejt synimin për barazi gjinore dhe pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si organi kryesor për rregullimin e mediave në Maqedoninë e Veriut, është e përkushtuar për dokumentimin dhe përballjen e modeleve dhe rasteve të portretizimeve stereotipike të grave në ambientin mediatik dhe është e angazhuar në dialogun e vazhdueshëm me transmetuesit dhe mediat. **Portretizimi i ndershëm dhe qasja në media, veçanërisht në nivelin lokal, mund të ketë dobi me përforcimin e kapaciteteve të ASHMAA-së për ndjekjen e fushatave të zgjedhjeve lokale dhe nga ofrimi i trajnimeve plotësuese të synuara për gazetarët.**

Po ashtu duhet mbështetur edhe propozimet e dhëna nga praktikuesit e medias të intervistuar për këtë studim për të shmangur stereotipet e vazhdueshme gjinore për një promovim aktiv të barazisë gjinore. Në veçanti, **duhet bërë përpjekje për t'i mbështetur propozimet e praktikuesve të medias të shprehura në këtë studim për inkuadrimin e perspektivave kryesore të barazisë gjinore në politikat redaktuese dhe për krijimin e mekanizmave të burimeve njerëzore për të vëzhguar dhe promovuar avancimin e grave në politikën mediatike.**

Përfundimisht, për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të abuzimit onlajn si një nga pengesat kryesore për pjesëmarrjen efektive të grave në proceset politike dhe zgjedhore, **duhen bërë përpjekje më të mëdha nga të gjitha organet shtetërore përgjegjëse për ndjekjen më efektive të mediave onlajn në përgjithësi dhe në veçanti lidhur me fushatat mediatike onlajn gjatë zgjedhjeve kombëtare dhe lokale.**



**SUPPORT TO  
ELECTORAL REFORMS**

ПОДДРШКА НА ИЗБОРНИ РЕФОРМИ  
MBËSHËTETJE E REFORMAVE ZGJEDHORE

Ky studim është pregaditur në suaza të projektit "Mbështetje për reformat zgjedhore" të Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Qëndrimet dhe përmbajtja e shprehur në këtë publikim, nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit, projektit apo realizuesit.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



[www.electoralreforms.mk](http://www.electoralreforms.mk)



Support-to-Electoral-Reforms